

INTERVISTË ME RESMIJE CANËN

Prishtinë | 15 janar, 2016

Kohëzgjatja: 128 minuta

Të pranishëm:

- Resmije Cana (E intervistuara)
- Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
- Jeta Rexha (Intervistuesja)
- Rina Krasniqi (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - e intervistuara shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale të jepin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

Pjesa e Parë

Jeta Rexha: Zoja Resmije, a prezantohesh t’lutna? Edhe me na tregu ma shumë diçka për fëmininë tonde t’hershme, edhe vazhdon mandej me memoriet: qysh ka qenë fëminia, qysh ka qenë familja jujë, rrathi ku jeni rritë, shkolla, krejt çka mban mend për atë periudhë.

Resmije Cana: Po. Ju falemnderit për kujdes. Jeni t’mirëseardhuna, çka muj t’iu ndihmoj. Quhem Resmije Vokshi Cana. Rrjedh prej nji familje patriotike, si çdo familje tjeter shqiptare, në rrethana specifike të rritura. Jom... e don vitin?

Jeta Rexha: Ëhë.

Resmije Cana: Jom e lindur n’vitin 1943, në Gjakovë, ku atje kom kry shkollën fillore edhe ma vonë shkollën e mesme, në gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë. Familja ime, përveç babës dhe nanës, kemi qenë tetë fëmi, hiq ma pak (qeshet). Dhe, kuptohet, ka qenë vështirë për prindëtë tonë. Mandej secili jemi mundu n’ményrën e vetë me i ndihmu, me kontribu, me kursy, sa kemi ditë e mujtë. Kryesisht n’atë kohë vendasit e mij, krejt shqiptaria mendoj qe janë marrë me bujqësi, me kafshë, me naj lopë, naj dhi, edhe me qato janë argëtu. Kanë ble grunë. Na kemi pasë, kemi pasë... familja ime ka qenë pasanik edhe kemi pasë kushtet. Për kah ushqimi s’kemi hekë. Se barëm atëhere, ma vonë do t’a tregoj, është deshtë me dhanë... ka qenë ai nifarë *otkup*¹ i thojshin, ëë nalu...

Erëmirë Krasniqi: Taksë?

Resmije Cana: N’formë takseje, po, si angazhim, si obligim shtetit, prej pasunisë sate u dushe me i dhanë. Kemi pasë lopë, dy bullica, edhe plus grunin qe e kanë bo. E kom pasë babën... ka pasë tokë. Edhe ate kur e ka marrë prodhimin prej fushës, e ka pru n’shpi. Pranverë, ose ka vjeshta është deshtë me e pagu qatë taksën për t’cilën po flasë. Edhe ndonjiherë nuk i ka dalë qaj prodhim çka ka nxjerrë, nuk i ka dalë. Është dashtë me dalë me ble, për me ia kompletu atyne. E kemi pasë hamarin, s’di sa mijë kille grunë i ka zanë, se kemi pasë tokë shumë. Edhe misër, ka qenë ai koshi i veçantë për mos m’u mykë, me thupra, n’skaj aty, anash oborrit.

Barëm lagjja aty, ka pasë njerëz shumë t’vorfun. Bishin, si tash që po binë këto ndihmat, qe po përtrihet historia, ato ndihmat i bishin tomël pluhun. Ai tomli pluhun me do kutia të metalta. Edhe iu

¹ Serb: *otkup*, haraç, taksë.

shpérndajshin do familjeve, kush ishin ma t'vofun. Edhe nifarë si ynyrë, nifarë voji {e rrudhë fytyrën në shenjë mospëlqimi} qì u kelbke mahalla, krejt rruga. Po atyne mirë se ju vike.

Na kemi pasë t'lynë, gjalpë t'kafshëve. Po është deshtë mun' i madh për me ardhë deri te këto gjana ushqimore. E ata t'lagjes vishin lypshin djathin që e bajshim na, u ushqejshim me djathë me plotë ynyrë. Ato vishin e lypshin qatë... qysh p'i thojnë tashti, ajo? Hirra. Po shitet tash, po shitet në kësi, nëpër shitore. Vishin e lypshin qasi me çu bukën, bukë thatë. Mizerje.

Erëmirë Krasniqi: Kjo është mas Luftës të Dytë Botënore, menihere?

Resmije Cana: Meniherë mas luftës.

Erëmirë Krasniqi: A keni punu krejt familja n'këtë ekonomi familjare?

Resmije Cana: Po t'tontë, krejt, krejt. Nana n'mënyrën e vet me gatu, me bo me hongër, me bo kos, me bo tomël, me nxjerrë gjalpën prej kosit. Atëhere s'ka pasë... dikur ma vonë dulën ato me i tundë me rrymë, si tash që po janë. Atëherë u duke me dorë. U duke me nejtë dy-tri orë dej kur u bajke, për m'i nxjerrë qatë ynyrën. Mandej shitshim, e vishin e lypshin njerëzit, "A ban ni..." kanë qenë ato si qitash qito qe p'i blejnë, ato kanë qenë keramikë, si këta gërgarqitë². Vishin e bishin ato, "A ban me ma dhonë ni kësi?" vorba i thojshin atyne, si qeto plastikat qe p'i blejmë na tash kosat.

N'mënyrën ma primitive është deshtë me u gjetë. Dikush s'ka pasë mundësi, s'ka pasë tokë. Është deshtë me dalë me i ble. I ka dalë edhe ma shtrejtë me dalë e me i ble. E këte qe deshta, se për ato gjana... muhalif është, e pakapshme mund t'a qujshë. Për ju, e për ne. Është çu, e kanë blu grunin n'mulli, e kanë pru n'shipi. Është deshtë me pasë kali, dy kuajë. Mandej si bicikllat kanë pasë. Kanë pasë ni gomar t'vogël. Me atë gomar shitetshin, me kry punë ma shpejtë. Edhe e kanë marrë grunin, e kanë blu qe thashë, qe tri herë po e përsëris. E ka sitë nana ime. Na shtike neve si fëmi. U duke qitash kama... i kam hala m'asociojnë, me hypë e me sitë. U kanë ajo ena e veçantë, edhe e vnojke sitën për me sitë, me nda grunin... ato, krunet prej millit. Edhe e ka marrë e ka shti nëpër kese t'najlonit, ku ka mujtë me gjetë atëhere. I ka mushë qato thasë t'najlonit. E kanë çelë ni gropë mund t'a qujë, sa gjysa e qesajna {tregon hapësirën me dorë} edhe e kanë marrë e kanë shti me babën tem, e kanë shti millin qaty, n'qatë gropë.

Edhe kapigjikat, *prallaza*³ na i thojmë, qe i kemi pasë, thojke nana e jem, unë ato pak i majë n'men. I vnojshin sofrabeza, naj teshë, naj çarshaf t'dyshekit, i vnojshin nëpër kapigjika. Me kojshitë kemi pasë kapigjika. I vnojshim, se po na sheh najkush. Edhe kur kemi qenë na n'gjumë, ata krejt këtë proces e kanë ba ata dy vetëm. I kanë mushë ata thasë, i kanë shti qaty n'tokë. Mandej i kanë qitë përsipëri prapë najllona, edhe e kanë qitë dheun përtimi.

Erëmirë Krasniqi: Qashtu e kanë rujtë, a?

Resmije Cana: Qashtu e kanë rujtë. E kanë rujtë, se janë ardhë ata, kanë lypë apet. Kanë hi, thojke, "Hike kontrolla me këpuca". Se na thojshin Edhe mandej tha, "Çka bojsha, kapsha sa e kishim mjellë

² Gërcak, enë dheu.

³ Serb: *prelaz*, vendkalim.

arpagjikin,” farën për me mjellë qepë me bo, “i skajojsha, mandej përmi qata i qitsha, edhe ja hupsha shenjet, për me kuptu qe s’ka këtu kurgja”. Qaq, për me kriju ni ekzistencë kanë luftu. Mandej kanë majtë naj lopë, e kanë pre viçin për dimën. Pula po ashtu.

Qeshtu ka qenëjeta, shumë, shumë e keqe. Megjithëse, edhe ka ana e shtetit ka pasë edhe mosmarrëveshje, keqpërdorime. Na n’atë kohë, krejt mahalla ishin konë ardhë, e maj men’, me ardhë me dëgju radion, ka dhonë lajme. Janë ardhë me ngu, qaty janë hi, shka po thojnë, shka po bohet, tek po bohet, “A ban me ardhë?” “U duke,” thojke, “m’u rujtë se vishin...” tash për shembull t’ka pa ty që je si ma i zoti, e kom pasë shumë t’afëtë babën. Shtatë hektarë tokë i ka ble, mirëpo me shumë mundim. Ka bo nana jeme vek, me pamuk. ... do farë fyshtëza queshtu. Na dy motrat qe ishim ma t’medhajat hypshim këtu n’miner. Nuk kemi pasë kauqa. Janë kanë do t’dërrasave. Edhe hypshim i bajshim ata, ia rregullojshim. Mandej u duke m’i bo... kanë qenë [do] lemje ... Kështu e kanë sjellë, ajo lemja u sjellë, e ka pshtjellë, e ka bo ma t’madhe. Edhe queshtu, me fije. Fukarishi dej n’maksimum (qeshet).

E baba im për mos me harxhu pare, ai ka fitu, ka marrë punëtorë. Kemi pasë çobanin që i ka qitë gjatë [shtazët] tonë me kullotë. Për mos me i harxhu paret, dej kur iu ka... kjo nona jeme ka bo vek, edhe na ka bo neve si këmisha, queshtu si t’shkurta. Edhe pelena, beba që ka ardhë. I kom dy motra binake. Janë tash ka 65 vjeç. E atyne, kur ka pasë me lindë e ka pasë veç ni djep. Kur ka marrë me lindë, tha, “Nuk e disha qe po du m’u bo dy”. Ia ka marrë gjyshes djepin, e ka shti këtë tjetrën, edhe me qato pamuka iu ka bo pelena.

Erëmirë Krasniqi: Hajt për shkollën fillore, qysh ka qenë edukimi n’atë kohë?

Resmije Cana: Edukimi nihere ka qenë deri n’klasën e katërt, u qujke shkolla fillore. Mandej n’qatë kohë hini n’fuqi... atëhere kur u regjistrojshe n’klasë t’parë, faktikisht tash klasa e pestë, atëherë i thojshin gjimnaz. Ai gjimnazi, katër vjet fillore me mësu me shkru. Mandej, klasë ma e naltë, shkolla gjimnaz. Mirëpo, ndërkohë u ndërru ai gjimnazi edhe u bo tetë vjeçare, n’qatë kohë kur unë kom qenë. E une, përpos kësaj e kom pasë ni motër ma t’madhe se une dy vjet. Ato baba nuk e lëshoi n’shkollë me shku, se ka qenë rrethi primitiv. Me shku çika n’shkollë, marre, turp. E ata e nali n’shpi, mue m’lëshojë, për shkak se ia kanë bo njerëzit, “Qysh i ki nalë?” Tash neve n’ka ardhë reni qe jemi rritë, kanë pasë edhe ata djemë. Po mandej edhe djemëve iu hupke interesimi, se u duke procedurë e gjatë për me ardhë deri te shkolla, e me ardhë dej... me fitu për shembull diçka. U duke qaty koma-dorës çka munesh me mbërrri, m’u ushqy.

E ajo metë. Ajo kur i ka pasë 19 vjet u feju. Erdhën e lypën, e panë ma e madhe, e zhvillume, u feju shkoi te burri. Tash e ka çikën 53 vjeçe. Është dy vjet ma e madhe se une. Motra jem çikën e ka 53 vjeçe, po është martu herët e ka bo fëmitë ma herët. Qishtu.

Erëmirë Krasniqi: A kanë mbajtë gratë çarçaf n’atë kohë?

Resmije Cana: Po, n’atë kohë kanë mbajtë çarçaf. M’kujtohet si fëmi kom qenë, i thirrën atëhere, si me thanë... dikur ma vonë u bo Lidhja Socialiste. Dikush ma, ma organizator, ma komunista, edhe i thirrën këto gratë, kush kanë ka, me dalë. Ishin me çarçafa, edhe e kanë pasë nifarë... si qito, qe qitash qe p’i sheh {tregon me dorë}, t’nejta. Tash këto... kom pa edhe këtu qe p’i qesin, edhe perden përpara, nifarë tyli. Ato kanë qitë nifarë tyli përpara, a knej deri n’fund t’komëve, qe si këto. Unë e maj n’men nanën teme, dulën. Po ka pasë çika t’reja që janë kanë t’fejume, e tashti iu ka dokë ajo thu’ ti i ka ra qielli n’kry. I ngrehshin

gratë, s'dojshin me dalë. Si sot m'kujtohet. Qysh me dalë? Hajde me naj fund t'çarçafit {e tundë kokën anash}. Oo, çfarë niveli! Gjynahi i Zotit.

E këto tash, une kisha apelu deri ku... po thujë ti i ka pru Lindja qito, e primitivizmi. U kapshin për dyrë (qeshet). Une qe i kom pa vetë. Ka qenë ajo, ni çikë e lagjes, e fejume, "S'du," thojke, "me dalë". Iu doke qe i ka ra qielli n'kry. "Nuk du me dale", u kthejshin e hishin i merrshin këta me zor (qeshet). Edhe mandej, për mos me hupë krejt atë marren, dilshin me çadra. I kanë pasë shti me vnu ato, shalla n'kry. Mandej me çadra dilshin {imiton mbajtjen e çadrës}, qatë ditë kur dulën. Edhe kur dilshin, mandej u rrallu, dej kur e boni t'vetën ajo. Dilshin me çadra, ia e vnojshin naj shallë, ja mandej nisën do syre, si këto qe p'i vnojnë do syre. I shtishin jo pallta, jo do si kostim qe kanë pasë. Ka qenë... tash p'i shoh p'i përdorin, pelosh, do si kostime, si bundat qe i veshshim dikur. Qasi, ato i kanë pasë për me dalën me gjezdisë, me shoqe, naj darsëm. Me qato dilshin dej n'çarshi. Kush me guxu me dalë, se u tutshin, iu vike marre. E mandej me qato janë dalë, janë pështjellë edhe e kanë kry qatë mision. I kanë pasë qitë një tri-katër herë, për me iu plasë marren. O Zot! O Zot! {mbulon fytyrën me duar}.

Erëmirë Krasniqi: E kush i qitke, kush i organizojke?

Resmije Cana: A?

Erëmirë Krasniqi: Kush i organizojke?

Resmije Cana: I organizojshin Lidhja Socialiste i thojshin ata.

Erëmirë Krasniqi: Aktivista, a?

Resmije Cana: Aktivista, po. E po, përpos kësaj parëz deshta me iu kthy, kanë qenë edhe qeta komunista, sikur sot shpiuna. Është deshtë m'u ruitë. E lëshojshim radion qe t'hashë, vishin me e ndigju radion. I jepke, ka qenë "Shqipëria e Lirë" "Zëri i Amerikës" në Washington, n'atë kohë ka qenë. Vishin e ngojshin, u bojshin palë gjinja.

Tashti e shihshim, unë e kom pasë ni djalë t'axhës n'klasë t'tretë n'gjimnaz. Domethanë ky gjimnazi qe u bo ma i aftë, ma i ngritun. Ka qenë nxanës i mirë. I vetmi djalë n'atë familje. Bash djalë t'axhës e kom pasë. Edhe vike te na m'i ngu radion. I erdh' koha atij me shku ushtar... o Zot! Edhe ka pasë familje, njerëz, qe kanë qenë t'predisponumë me t'a marrë mashkullin: vëllaun, ja djalin e dajës, ja djalin e axhës. I përcjellshin, sikur sot qe po thonë, "Shpiun", Kadri Veseli.

Kanë qenë n'Gjakovë... {troket me dorë mbi tavolinë} janë familje të njoftuna qe kanë marrë n'qafë t'ritë. Vishin i merrshin, "Hajde, a po don me t'qitë n'Shipni?" Për shembull i ka pa ata shkollartë, tash ata e ka kapë vërvëla [nervozë e brendshme]. Shkojshin ushtarë, i ka burri jem edhe listën e ushtarëve t'vramë n'kësi... se p'e bajë ni paralele, noshta po bajë digresion. Ushtartë e vramë n'Ushtrinë Serbo-Slave, Jugosllave, edhe i maltretojshin, i vrajshin, me pretekst kishe kanë bo vetëvrasje. Faktikisht ata i kanë vra.

Edhe qetë djalin e axhës tem unë e di, vike baba i vetë për natë m'i ngu "Shqipnia e Lirë". Se di ku ka qenë ajo me seli, s'di ku ka qenë. Edhe dikur vonë i kanë tregu... janë kyçë aty, se prapë po sillna rreth ni rrathi vicioz, i kanë thonë, "A po don me t'qitë n'Shipni?" se tash atij i ka ardhë thirrja, ftesa, për me shku ushtar.

Për me bo ushtrime, ni mujë ditë i qojshin me bo ushtrime ushtarake. Edhe tashti atij veç i ka ardhë [thirrja zyrtare] qe duhet me shku ushtar. Iu kanë sjellë qita shpirtshitun. Edhe burri jem n'shkrimet e veta e ka përdorë "shpirtshitun". T'ka marrë n'qafë, "Hajde," ka thanë, "a po do me t'qitë n'Shipni?"

Kanë qenë njerëzit specifikë, [që i] kanë pasë shitoret rrajë kufinit. Se Gjakova është shumë afër, rrajë kufinin. Edhe janë dalë i kanë marrë, kishe i kanë qitë. Mirëpo i kanë bo me sherr. Kanë çelë queshtu gropat, edhe janë marrë vesh me ata të policisë, qe kur t'vijnë, ai me çejz, atëhere s'ka pasë makina, ja me kali, ja me dy kuajë, t'ka hypë n'kali ty edhe vetë n'kali. Mirëpo i ka dhanë shejë atyne qe kur t'vimë te kufini, kur t'afrohem dije. Ja ia ka çu diçka t'bardhë, ja e kanë bo kohën kur me dalë ai atypari. Edhe ata kanë dalë e i kanë pritë. Kur janë afru ngatë kufinit, këta janë dalë. Ky kinse... e kanë bo atë gropën, e kanë mlu me diçka, e ky, qeky përcjellësi kinse ka ra n'atë gropë. E ky tjetri ka metë. Këta e kanë pushkatu.

Erëmirë Krasniqi: Qesi lloj montime kanë bo n'atë kohë?

Resmije Cana: Qashtu kanë bo montime. Edhe sot e kësaj dite, barëm shpesh burri jem... kjo motra e burrit tem e ka pasë njonin që e kanë pasë diçka fis, thojke, "Ju duhet me e leçitë ata". Ai ka marrë njerëz n'qafë, t'ri n'qafë, e atyne tashti iu kanë mundësu me bo shitore rrajë kufinit. Ponosheci, noshta iu ka ra me ndigju. Ponosheci është shumë afër kufinit me Shipni.

Erëmirë Krasniqi: Kjo ka qenë n'atë fazën kur kanë deshë m'i pastru krejt armiqëtë potencialë ndaj Jugosllavisë, a po?

Resmije Cana: Po, po.

Erëmirë Krasniqi: Mas luftës, kanë deshtë me i identifiku kush me çka është.

Resmije Cana: Se na kemi pasë si idol, si sot e kësaj dite qe e kemi idol Shipninë. Se shiptarë ata, shiptarë na. Ai Enveri me t'vetat. Megjithëse burri jem e ka dhanë ni mendim, thojke, "Sido që të jetë, ai e ka mbrojtë prej armiqëve tjerë. Populli ka hekë shumë, mirëpo kanë qenë t'gatshëm Italia, Jugosllavia, Greqia...ma nuk kish' ekzistu Shqipëria si shtet". Se qysh ka pasë...

Pjesa e Dytë

Mas përfundimit t'shkollës tetë vjeçare u regjistrova në shkollën e mesme, qe n'atë kohë ishte e vëtmja derë për me vazhdu ma tutje, në gjimnazin e përgjithshëm "Hajdar Dushi", Gjakovë, drejtimin shkencor-gjuhësor. Katër vjeçare ka qenë atëhere. Mandjej ndërkokë u hap Normalja, mas nja ni viti a dy. Normalja ka qenë këtu n'Prishtinë. Mirëpo përparësinë ma t'mirën e ka pasë Gjakova, se n'kohën e Italisë kishin pasë pru arsimtarë prej Shqipërisë, n'Gjakovë. Prandej e kanë pak ma specifike gjuhën.

Erëmirë Krasniqi: Kjo iu përgatiti për çfarë profesioni, ky edukim?

Resmije Cana: Ky edukim, për me vazhdu si... atëhere me kry shkollën e mesme ka qenë si me kry fakultet. Kanë qenë tanë profesorat, mandej qe m'kanë dhonë mësim n'Gjakovë n'shkollë t'mesme, jonë ardhë këtu. Kom pasë Besim Bokshin, akademikun. Enver Gjerqeku, Musli Mulliqi. Musli Mulliqi n'tetë

vjeçare m'ka dhanë vizatim. Mandej Ekrem Murtezai, filozofinë, latinisht. Kanë qenë shumë kuadrat e forta, qe sot ni doktor shkence qasi përgatitje s'ka pasë. I kanë kry n'Beograd. Masi e kreva shkollën e mesme u kyça me ni marrëdhanje pune me ni shkollë n'periferi t'Gjakovës. Ndërkhohë, u takumë, u fejumë me qetë burrin tem, Zekirja Cana, profesor i historisë.

Erëmirë Krasniqi: Kur erdhët n'Prishtinë, n'cilin vit?

Resmije Cana: Në vitin '67. 1967 jam martu, '66 besa. Jo, '67-shin jam martu, '68-shin m'ka lindë djali, i madhi, qeky vjehërr i Aresit. E në jetën bashkëshortore kom tre djemë. Edhe ata janë familjarë, janë të ngritun.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenëjeta n'Prishtinë, n'atë kohë?

Resmije Cana: Nisoj gati. Këtu kjo pjesa, Aktashi, u kanë qikaq lloç {tregon me dorë}. Kur dilsha une, shtikllat qe m'i kanë ble përm' i veshë, s'i kom veshë këtu. Ujë s'ka pasë, kanalizim s'ka pasë, ujësjellës s'ka pasë, kanalizim s'ka pasë. Kur dilshin, si t'a qitshin kamën n'tokë, u rrëzojshin fëmitë. Qyshtu. Mandej burrin tem e kanë përjashtu prej arsimit, para se m'u feju. Kur isha n'shkollë t'mesme pata ndigju qe e kanë përjashtu pi arsimit. Se burri jem e ka pasë shok burrin e qesaj motrës t'madhe qe iu tregova, edhe ata, familja e tij i kanë propozu, e u bo, u murren vesh, po nëpërmes familjes. Megjithëse jemi taku dy-tri herë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh vendosët me ardhë krejt n'Prishtinë?

Resmije Cana: Ky [burri] ka pasë ardhë përpara, se e kishin pasë hekë pi arsimit. Ka hy n'punë n'këtë shkollën normale niherë, ka dhanë mësim. Mandej prej normales ka dalë në shkollën... çka është kjo te... kur t'shkojsh te... "18 Nantori", a "19 Nandori", ajo shkolla?

Erëmirë Krasniqi: Shkolla Teknike?

Resmije Cana: Teknike, qaty e kanë pranu. Se pak si i dyshimtë, se nuk ka pasë qasje, përgatitje politike t'përshtatshme për kohën.

Erëmirë Krasniqi: Nuk ka qenë i përshtatshëm?

Resmije Cana: I papërshtatshëm për shtetin. Për organet.

Erëmirë Krasniqi: A ka pasë naj aktakuzë ndaj tina?

Resmije Cana: Po, ka pasë. Ka pasë aktakuzë. Kur ka qenë gjatë studimeve n'Beograd, e kanë formu shoqatën "Përpjekja". Edhe sot e kësaj dite ekziston. E, për tri-katër ditë janë ardhë i kanë marrë këta qe e kanë themelu shoqatën "Përpjekja". E mandej e kanë përjashtu edhe prej fakultetit. Mandej e ka dhanë me vonesë [provimin e diplomes], mirëpo atje ka qëndru, n'Beograd. Ka qenë Agim Gjakova, Ali Aliu dhe burri i jem qe e kanë themelu qatë shoqatën "Përpjekja". Shoqatë studentore, si tash Unioni i Studentëve. Ajo vazhdojke.

Erëmirë Krasniqi: ... qytetin, Prishtinën n'60-tat?

Resmije Cana: Kur kom ardhë une, ujë s'kom gjetë këtu. N'këtë familje s'kanë pasë hala ujë. Ka qenë t'u u ndërtu shpia. E kanë përjashtu edhe prej shkollës "18 Nandori", 18, a 19 nuk e di qysh thirret tash.

Jeta Rexha: Shkolla Teknike.

Resmije Cana: Po, Shkolla Teknike. Po atëhere ka pasë emrin 18... Shkolla e Mesme Teknike "18 Nandori", a "19 Nandori" nuk e di me çfarë rasti. Edhe e kanë përjashtu. Mandej e kanë qitë në Arkivin Krahinor me punu, si historian. Ndërkohë edhe aty e hekën prej Arkivit, e erdhën Brionet⁴. Brionet është ni periudhë shumë e mirë për shqiptarët. Ke Rankoviqi n'atë kohë. Rankoviqi e ka rrjepë popullin shqiptar. Edhe ka pasë korriera boll, kështu që nuk ka hjekë shumë. Valla u dushe ma shumë m'u rujtë prej ni shqiptarit se prej ni shkaut.

Erëmirë Krasniqi: E pse po thu periudhë e mirë kanë qenë këto Brionet nëse ka qenë Rankoviqi në [pushtet]?

Resmije Cana: Është hjekë.

Erëmirë Krasniqi: A, ka ra.

Resmije Cana: Ka ra Rankoviqi, mandej Brionet. Ka qenë ni mbledhje qe është bo n'Brione, Brionet n'bregdet. Diku në Beograd është mbajtë ni mbledhje e partisë edhe është rehabilitu ky burri i jem, edhe shumë njerëz tjerë që kanë qenë [te konsiderum si t'papershtatshem]. Qita qe kanë shkollat emnat e tyne. N'qatë kohë, se di sa iu ka ra, qe ka vdekë qiky Kelmend Rizvanolli.

Erëmirë Krasniqi: Kush ka qenë ai?

Resmije Cana: Ai ka qenë nipi Kadri Kusari. Është ni shkollë n'Gjakovë. N'qatë kohë është përjashtu edhe ai me burrin tem. Barëm ai ka shku dam. As s'u martu, s'ka kriju familje. E kanë përjashtu pi arsimit. E kanë kry n'Beograd fakultetin me burrin tem. E kanë shti n'burg, edhe u mbrapshtu.

Erëmirë Krasniqi: Kur keni fillu me punu ju?

Resmije Cana: Mandej po them është rehabilitu [Zekeria]. E kanë pranu. Është themelu Instituti Albanologjik. Niherë Instituti...

Erëmirë Krasniqi: N'cilin vit?

Resmije Cana: N'68-tën. N'qatë vit, '67-68. Se edhe niherë është themelu Instituti Albanologjik. Edhe niherë ish' konë themelu Instituti Albanologjik. Aty kish qenë Zekeria Rexha. Mandej ata e kanë qitë n'Shipni. Se i papërshtatshëm për regjimin jugosllav. E, e kanë mbyllë atë institut. N'67-68, u themelu për s'dyti. Qatë here ky [Zekeria] ka konkuru edhe e kanë pranu. Se s'ka pasë t'drejtë me dhonë mësim nëpër fakultete. Se pak si me shejë, me balushë (qeshet).

⁴ Plenumi i Brioneve (1966-1981) - rishikoi politikën e gabuar ndaj shqiptarëve dhe po i hapte dyert e perspektivës|| për shqiptarët. Plenumi ia hodhi fajet nacionalizmit serb apo më shkurt, Ministrit të Punëve të Brendshme të Jugosllavisë Aleksandër Rankoviqt. Në këtë periudhë, shqiptarët sadopak patën një jetë më të durueshme dhe morën frymë më lirshëm.

E tanë jetën vjehërra jeme u mytke t'u thanë, "Kuku, qe!" Po nejse, e ka fitu ata. Mandej ka qenë i përkushtumë, ka punu aty, ka regjistru shkallën e tretë n'Beograd. E ka kry shkallën e tretë n'Beograd. Shkojke mandej për provime. Ministria e Kulturës ka qenë, i jepke nifarë fondi për me shku me jetu n'Beograd, me u enë, me paraqitë provime.

Erëmirë Krasniqi: Si rezidencë, po.

Resmije Cana: Po. Mandej i jepshin me fitu, mirëpo kur vike nuk i dilke rroga, se kanë qenë rrogat e vogla. Po nejse, edhejeta ka qenë, s'kemi pasë standard, as s'kemi pasë kërkesa, bonë çka t'munesh. Vike, e ka poshtë bile [në katin e parë t'shpisë], e ka maqinën e shkrimit. Gjithë natën shtypke, përkthejke, batojke. I ka krejt punimet qe i ka botu. Mandej e ka bo ni përbledhje, i ka shti me ni libër. Për me majtë u duke me... shpia kur erdha une këtu ujë s'patë. Me kofa bajsha pi kojshive. Dy vjet s'kom punu, kur u bonë dy vjet e gjysë konkuroj në Ent të Teksteve. Në Entin e Teksteve, atëherë ka qenë Enti i Teksteve qì i ka botu librat, tonat. Osht' recenzent i shumë librave. Edhe t'vetat ka shkru. E ka shkru mandej n'bashkëpunim me atë Branko Horvatin, ma vonë. E ka librin...

Në vitin [1970], me 1 mars isha n'muajin e tretë shtatëzanë, tash me t'dytin, me qitë Longarin. Edhe filloj tashti, u çelën dyrtë për shqiptartë, për intelektualët shqiptarë, u çelën dyrtë. Kush ish' i zoti me punu, me shkru, nuk t'nalke kush. Edhe une isha shtatëzanë me t'dytin. Ka qenë Fakulteti Juridik-Ekonomic, bashkë. Barëm ka qenë bashkë, është konë si filialë e Beogradit, Fakulteti... *Ekonomski Fakultet, Pravno Ekonomski Fakultet u Beogradu*. Edhe vishin profesorat, shkijet krejt këtu jonë konë, prej Beogradit. Po gradualisht, në vitin '70 u shkëput, se erdhën ditë ma t'mira, u shkëput Universiteti i Prishtinës prej Universitetit t'Beogradit.

Erëmirë Krasniqi: A fillutë ju me punu me 1 mars?

Resmije Cana: Po me 1 mars t'70-tës une u pranova n'punë. Me 1 mars kom fillu me shku n'punë. M'pranunë n'punë.

Erëmirë Krasniqi: N'Fakultet Ekonomik?

Resmije Cana: N'Fakultet Ekonomik-Juridik. Mandej u ndamë: Juridiku veç, Ekonomiku veç. Atëhere ka qenë dekan Suriya Popovci, për dy fakultetet.

Erëmirë Krasniqi: Si çka punojshit atje?

Resmije Cana: Administratë, e n'arkivë m'patën pranu. Se atëhere u nda Juridiku prej Ekonomikut. U bo ni arkiv anej, ni arkiv knej, edhe e shfrytëzova. Shoktë, se kanë metë plot, qe janë metë... shoktë e burrit. Ka qenë prodekan për mësim, jo anëtar, kryetar komisioni profesori Fuat Rizvanolli, edhe Suriya Popovci ka qenë me këta n'Beograd. E barëm kish' pasë thanë Surijaja, "Ishalla nuk ban fëmi". T'kqyrshin, t'vertetojshin a mos je shtatëzanë për mos me t'pranu. Po nihere, atëhere s'u doksha une. E hongra, meta mrena. Mandej kom punu ka katër orë. Kur ka lindë ky [fmiu i parë] n'nandor, une veç kom fillu ka katër orë me punu. Se atëherë kishe t'drejtë, gjashtë mujë punojshe kah katër orë, mandej u dushe me vazhdu me orar t'plotë. E kom pasë vjehrrën n'shpi, ajo u gjëzu qe hina une n'punë, u bo edhe ni krah, edhe tha,

“Une t’ a kqyri djalin”. Mandej erdh edhe ky i dyti, u bonë dy. E pata marrë mandej ni shërbëtore, se s’mbërrike. Qeshtu.

E kreu magjistraturën n’Beograd. Shkumë n’mbrojtje me Ymer Jakën e me grunë e vet. Kur shkumë n’mbrojtje – veç edhe qita kom për obligim me iu tregu – ishte ni Radmila Stijanoviq, ka qenë ajo ni profesoreshë, doktore e shkencës edhe dy anëtarë t’komisionit. Ajo po i thotë, “*To nije tako, nije tako profesore Cana, druže Cana, kolega Cana,*” [Nuk është ashtu, nuk është ashtu profesor Cana, shoku Cana, kolegu Cana”] cërc-mërc, edhe...

Erëmirë Krasniqi: N’çfarë konteksti është kjo? A është n’mbrojtje t’temës, a?

Resmije Cana: Po, n’mbrojtje t’magjistraturës, po. Se atje e ka kry me provime, mandej mbrojtja atje u bajke. Se ajo ishte n’kuadër t’Universitetit t’Beogradit. Barëm e ka *Univerzitet u Beogradu*, qj e ka marrë. Atëhere ky u çu e i tha, “*Nije tačno*” [“Nuk është e vërtetë”]. Ajo ia dha ni version çfare i konvenonte atyne anëtarëve t’komisionit.

Erëmirë Krasniqi: Historik, apo?

Resmije Cana: Po. Tha, “*Nije to tačno. Tako je kako ja sam pisao*” [“Nuk është e vërtetë. Është ashtu si e kam shkruar”] qysh kom... ju a merrni vesh sebisht?

Erëmirë Krasniqi: Po.

Resmije Cana: “Qysh kom shkru une aty, qashtu është”. Edhe u çu n’kamë edhe i mshojë tavolinës {e godet tavolinën me dorë}. Unë kur dulem n’pauzë, tash komisioni e vlerësojke punimin, une pi thomë, “Zeqë, çka t’u deshtë ty me fol, m’i thanë ‘*Nije to tačno?*’” Tha...thashë “A e di qe nuk t’ aaprovojnë, nuk e krynjë? Nuk ta japid...”

Erëmirë Krasniqi: Nuk diplomon.

Resmije Cana: “Nuk diplomon”. Tha, “Në ta provojnë”. N’atë kohë! Thashë, “Ti me sa menë?” “Pse,” tha, “Është e drejtë e jemja”. I tha, “Kqyre n’filan faqe qysh shkrunë, n’filan faqe, rreshti qikaq, kapitulli qekaq”. Atëhere na, “*Jedna pauza*” [“Një Pauzë”]. Dulem. E po thomë kur dulem, thashë, “Pse thoshe ashtu djali?” “Pse,” tha, “une me dokumenta flas. Unë prej kresë teme nuk e qita”. Kur himë, n’komë, thotë, “*Čestitamo ti, urime. Keni kry me sukses brilant punimin*”. Edhe provimet i ka aty t’dhanuna qe e ka marrë. Sa boni fjalë. Qeshtu. E ka kry, mandej...

Erëmirë Krasniqi: N’cilib vit?

Resmije Cana: N’68-tën. Jo n’68-tën jo, ma vonë. A ishte djali i vogël? Po m’doket dytë kanë qenë. Ma vonë se dej kur është deshtë me punu punimin e magjistraturës, qekaq e ka {tregon me duar}. Mandej t’doktorakurës këtu. Qaty i kem ato, i ka diplomat. U duke me punu, me bo gjurmime. Shkojke Cetinje, përfaqësia për burime arkivore Beograd, e m’i grumbullu. E, n’Kotorr, kisha n’Mal t’Zi. Është ajo kisha, Don Lush Gjergji jo, po është ni prift, ka qenë atje. Shkojke, atje flejke, n’kishë. Kisha e Tuzit, tash m’u kujtu. Barëm edhe unë një dy herë kom flejtë aty, kemi flejtë. E mandej n’Shkodër nuk e lejshin, s’kishin kontakt

me... kur u bo Lidhja e Prizrenit e kanë thirrë. O shku ni aoutobus. Hera e parë qe kanë shku intelektualët n'Tiranë.

Erëmirë Krasniqi: Ngjarje përkujtimore e Lidhjes t'Prizrenit po mendoni?

Resmije Cana: Po, përvjetori i Lidhjes t'Prizrenit.

Pjesa e Tretë

Erëmirë Krasniqi: Tregonon qysh ka qenë Universiteti n'fillimet e veta, ju kur keni punu. Se qatëhere është edhe fillimi, ju kur ia keni nisë.

Resmije Cana: Po, po. Me '64-tën ish konë qenë prej... se këta kanë shku me studiu n'64-tën, a n'61-tën ish' konë hapë Universiteti, po *Universiteti u Beogradu*, filiala Prishtinë. E, profesorët serbisht kanë spjegu. E mandej kur u ndamë, qe u shkëput prej Universitetit t'Beogradit, nuk shkojë shumë n'qatë kohë kur une u pranova. Qe thashë u bonë dy arkiva, dy dekanate, dulën dekajtë anej, dekajtë knej. Biblioteka, krejt serbisht kanë qenë librat. Krejt mbrojtja e magjistaturës e burrit tem ka qenë serbisht. E, vishin përgjurmime prej Beogradit. Studentat qe magjistrojshin atje, vishin. I ka pasë dy kolegë, merrshin materiale këtu n'Kosovë. Shkojshin nëpër terrene me pa monumente historike, me pa... sikur sot qe shkojnë, qe vijnë prej Shqipnisë edhe qe jemi shku n'Shipni. Ata vishin, studentat, sidomos t'degës t'istorisë, gjeografi po ashtu.

Mandej Mjekësia u hapë ma vonë. S'ka pasë hala as kompjutera, vonë u bonë. Shtypshin, proceset i bajshin. Kanë pasë daktilografë, kanë pranu. U duke fletëparaqitjet m'u punu me dorë, m'u regjistru me dorë n'libër amzë. Krejt janë shënu diplomit. Mandej une qatë punën qe e kom kry, i regjistrojsha, për shembull ni kërkesë për dekanat, për me paraqitë provim, për me regjistru vit, u duke m'i regjistru nëpër libra. Mandej ato i mbledhshe n'fund t'vitet kalendarik, u mbledhshin, u bojke ni libër që nesër me t'interesu me marrë vesh secili për bursë, për kredi, jepshin dikur ma vonë. Nisën kredi me dhonë firmat, këto fabrikat.

Erëmirë Krasniqi: Studentave, a?

Resmije Cana: Po, studentave. Mandej studentat qe ishin me notë ma t'naltë mesatare, i jepshin bursë universitare. Krejt qita profesorat qe janë te na, janë qe kanë qenë studenta me bursë universitare. Kanë pasë notën e naltë mesatare. Kanë mësu, kanë studju. Tash për sot, ma nuk janë meritore, mirëpo sot nxanësi i shkollës t'mesme nuk i dinë qito. Tash unë për ma vonë kom ardhë, qe i kom përcjellë këto vite, me 1 mars t'70-tës jam pranu, me... kur dulem, t'90-tën na qiten prej këtuhi. Se di kur i kom bo 65 vjet, qatëhere ni vit masi m'vdiç burri kom dalë n'pension. E kom fjalën, tash ma vonë dolën edhe profesorat t'papërgjegjshëm, edhe studenti. Ti kur s'ia tregon derën dikujna, për shembull ty a të ka mësu nana, baba me hecë? Nana me hecë, me t'mësu me hogër. Profesori, mësuesi është ai meritori.

Une e maj n'menë n'shkollë t'mesme, n'tetë vjeçare kur kom qenë, profesori i gjuhës shqipe na ka marrë ma na mësu qysh shkruhet letra, qysh shkruhet lutja, qysh shkruhet zarfa për m'i çu dikun. Kur vishin këtu

studentat, une ia jepsha ni letër, s'i kishin ku m'i marrë ni letër, s'i kishin kushtet. Ia jepsha ni letër, thojsha, "Shkruje ni lutje," tash llogarite mas, mund t'a qujë mas 20 vjete, 15. Po edhe mas 20 vjete, qitash vonë m'ka ndodhë, bile shpesh e përmeni kur takona me shoqe, "Merre shkruje ni lutje," e kapke lutjen, tash qysh është A4-shi, qetu naltë ia niske, "Çka me shkru n'lutje?" qekjo është dobësi e arsimtarit të landës t'gjuhës. Ai s'ia ka dhanë bazat, ai ku ka me ditë qysh shkruhet lutja. Neve na ka pasë mësu me zhdrypë ma poshtë, me fillu, organit i drejtohesh. Mandej përbajtja; mandej data; mandej adresa: emri edhe numri i indeksit, për çka po lypë. Ai ia niske qetu, thojshja, "Ti, a qekaq shumë ki me shkru a?" (qeshet) "Po, s'di". "Qysh more s'iu ka mësu arsimtar?" tash ku me fajësu une ata, a është qashtu? "S'na kanë mësu".

Mandej qashtu shkojke, pa kry. Thojke, "E mos ditsha me..." qato m'dulë prej hatrit, "mos ditsha me shkru, une di me folë" (qeshet). E tash këta po dinë me folë. Qishtu ka ardhë, qajo periudhë. Se ka ardhë t'u ra interesimi, t'u ra me t'mësu, me t'a kallëxu derën, "Qekjo është qeshtu, qekjo bohet qeshtu".

Erëmirë Krasniqi: A mundesh me na tregu për t'90-tat, qysh iu kanë përjashtu prej punës? Qysh ka ndodhë krejt qajo, qysh ka ardhë deri te përjashtimi i krejtve prej institucioneve?

Resmije Cana: (Ofshanë).

Erëmirë Krasniqi: E keni pasë ni epizodë herën e kalume qe na ke thanë.

Resmije Cana: Po, iu pata thanë. N'atë kohë, n'vitet e '90-ta bojshin protesta, u çojshin grupe-grupe studentat, dilshin n'protesta. Masanej dilshim edhe na, e lishim venin e punës. Atyne s'iu përqejshin dekajtë. U duke me u rujtë se shteti i ka pasë frenat përpara, edhe na ka përcjellë. Mandej simbas... i seleksionojshin simbas personalitetit, për shembull grupe-grupe ia nisën me i përjashtu. Niherë i përjashtunë do çka kanë qenë që janë familje patriotike, është ndigju për to. Se ka punu shqiptari, shqiptari ia ka çelë rrugën. Edhe sot e kësaj dite shqiptari p'i mbrapshton punët. A i gjetën tonë qata çka kanë qenë nëpër burgje babat, i përjashtojnë. Ja vëllaun, ja ia përjashtojshin... kanë përjashtu plot studenta. Une sot i majë n'menë, qì kanë përjashtu pi fakultetit, se kanë qenë t'papërshtatshëm.

Burrin tem e kanë përjashtu pi shkollës, shkolla ekonomike ka qenë atje ku e kanë përjashtu, si i papërshtatshëm. Edhe na prunë neve vendimet. Se mandej ky si aktivist, ata e kanë ditë. Në grupin e parë ma prunë vendimin mu, qì m'qitën prej punës, prej atyhit. Hajde. Po kur ish' grumbull s't'u doke. Mandej gabimi im, une nuk jom meritore me ia lonë Hadrulla Goranit, po gabimin, gafin ma t'madh qe e ka bo, e ka bo qì u dalë edhe i ka thonë m'i lëshu vendet e punës. Me qatë rast ai e vorfënoj Kosovën për shumë kohë. Se u deshtë ata... mezi qe pritën ata me dalë na, me e lëshu punën.

Po, e bonë protestë, grevë, me 1 shtator, a me 1 tetor. Edhe ata mezi qe pritën me gjetë pretekstin, edhe na prunë vendimet me na qitë prej punës, si *nepodoban*, si t'papërshtatshëm. Është deshtë me dhonë për dy gjuhësi provim, se ata shkijet kur vishin studentat u duke me fol ti sebisht me ta. Edhe n'Këshill kur shkojshim n'mbledhje, për ni serb, [që] u konë aty, u duke me fol serbisht t'tanë profesorat.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ia dhanë ato vendime, ia çunë te shpia, a ju shkutë i morët, a qysh?

Resmije Cana: Na prunë n'zyre secilit. Ia japën korrierit. I prunë, unë i protokolojsha, i regjistrojsha. I prunë, i regjistunë, edhe dulë korrieri na shpëndau. Bile t'a bi une dosjen kur e kom marrë për pension. Edhe hajde mandej, çka me bo, qekjo ka qenë sekretare e dekanatit...

Erëmirë Krasniqi: Kush?

Resmije Cana: Safetja, na çoi te familja e vet, te vëllazënët e vet, qatje te kovaçët ku janë, te Hani i Dilit p'i thojshin, qatje.

Erëmirë Krasniqi: Atje u bartët krejt kolektivi?

Resmije Cana: Krejt kolektivi, me profesora. Po nuk dulem krejtë, nuk na qiten krejtve. Metën do. Mirëpo tash këta metën si me dy bëtha mund ta them popullorçe, me dy versione. Se ai qe metke, ai metke si i dyshimtë për mendimin tonë. Mirëpo ma vonë kur e kuptumë, ata na bajshin shërbim shumë t'mirë. Se na bishin letër, na bishin ngjyrë, asi farë shirita t'maqinës, dokumentat. Vike, i paraqitshin provimet, na e majshim evidencën. Kur vike deri te fundi, ai s'mujke me marrë çertifikatë t'diplomës. Atëhere me ata na... ata na shpëtunë. Mirëpo në fillim nihere i kanë kqyrë me shumë rezervë, se janë metë si bashkëpunëtorë, atëhere i qujshin. Qeshtu, çka s'po provojshe!

Edhe ata mandej na merrshin dosjet pi këtuhiit, pi fakultetit, e gjejshin mënyrën kur s'ishin ata serbët aty, i shtishin n'trup e na bishin neve atje. Se gjokje naj njoni punë, mezi qe ka pritë. Vishin masandej me indeksa pi katuneve, nëpër salla, nëpër garazha. U shkepën, i lëshunë me qira. Na barëm s'kemi hekë, këta punëtortë tjerë kanë hekë, se na iu merrshim edhe pare. U duke me ardhë ai pi fshatit, me autobus, e merrke indeksin. Ka ndodhë shpesh ia kanë shti indeksin n'gojë me përbi, policia. Se dilshin punktet i kontrollojshin.

Mandej kur vishin aty, u duke me i deshë këpuçat poshtë. Ata kanë pësu shumë randë, familja qe na ka çu kjo, ka qenë kolege me ne. Bojshin, hekurossin makina ata djemtë, edhe baba i vet. Mirëpo patriotë. Na ka majtë, rrymën e ka pagu, telefonin e ka pagu. Nisëm na m'u bo shpi. U bonë paret qe pagujshin studentat, pagujshin garazha me qira e i bojshin si salla. N'shpi t'atyne, t'asaj familje, kanë qelli për shembull si unë qetashti qetu n'gjumë, ia jepshin do studenta njonit qe kish me majtë provim, hikë, ata u duke me u çu. Kishin nga katër dhoma, u duke me u çu, m'i lëshu rrugën se vishin studentat. Qaq kanë sakrifiku.

Erëmirë Krasniqi: Qysh e ka pasë emrin familja?

Resmije Cana: Familja Zhushi. Atë ditë qe t'hashë. Nazmi Zhushi. Këto çikat masanej na nimojshin, e i mshefshin dokumentat n'shpi naltë. E erdhën policia niherë e na njekën edhe neve.

Erëmirë Krasniqi: Iu qitën prej shpisë a?

Resmije Cana: I shihshin ka po vinë n'lacje. Lajmërunë se po vinë policia. U çunë i kapën me fletëparaqitje, me dokumente, me çka kishim. Atje ka qenë, është ajo rruga që shkohet për Llap, te hekurudha. Pi shpisë t'atyne dilshim shkurt, edhe nëpër qatë bregun u ngjitëm, ikëm pa menë. Edhe as qe hinë, se i gjetën ata t'u ndreqë kerre. Ata mandej i dënunë, pronarët e shpisë. Ata kanë sakrifiku, mund

t'them si ni qe e ka kapë pushkën. Ma shumë ka sakrifiku ai, se ata qe e kanë kapë pushkën e kanë dalë n'front. Se vishin kontrollojshin. E bonë ata t'përshtatshme, e çelën rrugën kah me hi studentat. Na pritshin. Na bishin, zishin patate, na bishin. Pemë prej atjehit, kafe, çaj, kurgja s'na kanë lanë me pagu.

Erëmirë Krasniqi: Sa vjet ka zgjatë?

Resmije Cana: Tetë vjet. Mas tetë vjete kur u bo kjo marrëveshja, u lshunë lokalet, u lshunë fakultetet, u lshunë shkollat.

Erëmirë Krasniqi: Çka ndodhke në ndërkokë n'spinë e jujë?

Resmije Cana: Këtu mandej qe po thomë, ma prunë edhe mu vendimin me tona shoqet, metën do. Këtu n'shipi teme, burri jem ngajke poshtë e përpjetë. Edhe kur u kthymë, nuk di qysh ka shpëtu. Edhe po t'them, faleminderit Zotit, ka punu ma s'pari ai, se une sado qe kisha kontribu s'kisha mujtë, se femën. Është tjetër kalibër femna për n'atë kohë. Se tash po ngasin, po prapë nuk janë n'atë dritën qe duhet me kenë. Se edhe ato po ngurojnë, edhe s'pi përfillë kërkush. Shumë pak p'e përfillin botën femënore. Qysh ka qenë ajo qe vike, Kristinë ..., ka qenë sekretare për të drejtat e njeriut n'Evropë. Këtu ka ardhë, këtu ka qenë. Mandej burri jem e themeloi Këshillin për t'Drejtat e Njeriut.

Erëmirë Krasniqi: N'vitin?

Resmije Cana: A, se di vitin. Qe e kom aty.

Erëmirë Krasniqi: 1990? A është edhe ajo n'fillimin e t'90-tave?

Resmije Cana: Jo, ma vonë. Ma vonë. Deri sa u trandëm. Me pa çka po lypë. Helmimet kanë qenë n'vitin '90. Besa po, nashta t'90-tën.

Erëmirë Krasniqi: Çka ka ndodh n'helmime?

Resmije Cana: Helmimet kanë ndodhë në Podujevë. I kanë helmu nxanësat e ni shkolle t'mesme, edhe veç ka fillu ni eufori me makina. Kush ka mujtë, kush ka qenë studentë, kush ka qenë pak qe ka pasë ndjenjë kombëtare, kanë ngajtë. Ata ia kishin pasë qitë nifarë substance që n'ortë e mësimit u dridhshin nxanësat. Vjellshin, kishin marramendje, histerikë diçka u bajshin. Barëm [Zekeria] i ka inçizimet. E, me makina i bishin pi atjehit. Edhe plus ata thanë, "Këta po e imitojnë, po aktrojnë". E kanë pasë qitë këta serbët.

Si bashkëpunëtor shkencor, bashkëshorti im e ka përdorë edhe si zyre t'pranimit për çështje patriotike.

Erëmirë Krasniqi: Institutin?

Resmije Cana: Po, Institutin Albanologjik. Edhe aty kanë fillu. Ma s'pari kanë ardhë kush kanë qenë të burgosurit politikë, studentat. N'mes t'atyne kanë qenë, kanë ardhë edhe e kanë lajmëru burrin tem edhe profesor Anton Çettën. Edhe profesor Anton Çetta ka punu n'lInstitutin Albanologjik. Aty kanë qenë si aktiviste të para, kanë qenë Myrvete Dreshaj edhe Have Shalaj.

Erëmirë Krasniqi: Ato kanë ardhë me kërku ndihmë prej profesorave?

Resmije Cana: Ato janë ardhë m'u konsultu, me dhonë si mendim. Se natyrisht, t'u lexu iu ka ardhë idea, meqë populli kur është n'zor... se fillunë me plaçkitë, me rrahë, me burgosë.

Erëmirë Krasniqi: Serbët.

Resmije Cana: Po, serbët, shteti t'u burgosë t'pafajshëmit, t'u i rrehë. Edhe n'atë moment e kanë pru si vendim qe kur është populli n'presion të shtetit, lidhet ma shumë. E kanë marrë qëndrim që kanë qenë ato gjaqe... për ni ditë, s'di çfarë date. Ka qenë fillimi i pajtimeve. Po ata janë mbledhë, nja ni vjet kanë punu rreth përgatitjes, se si do t'përgatiten pajtimet e gjaqeve. Atëherë janë shku, e kanë marrë Anton Çettën se ai ka qenë profesor i gjuhës edhe ka mbledhë kangë, vjersha prej popullit.

Erëmirë Krasniqi: Studiues i folklorit.

Resmije Cana: Po, folklorit. Edhe ka shku nëpër oda, ka tregu ngjarje, është rrëfy. E mandej ata, edhe këto studentet janë marrë qe me u lidhë, me shku nëpër oda. Se çikat këto, mashkujt nuk i pranojshin. Edhe këto janë shku bashkë, i kanë çu fjalë nëpër familje. Kanë pasë... janë cakrru për ujë, për megje. Mirëpo n'mes rreshtash, ajo ka qenë ni pretekst tjetër: se ato gjaqet janë bo nashta edhe për megje, ndoshta edhe për vadë, mirëpo kanë qenë edhe me ni prapavijë tjetër: se ato femrat temperamente, si t'rejat, për shembull ka dalë, s'është banale, është shumë normale, ka pasë marrëdhanje me burrin e motrës, ose me djalin e axhës. E tash kjo është marrë vesh në fshat. Ja vëllau, ja baba kanë ni, u dalë e ka vra qatë dhondërrin, a kojshinë. Edhe kojshia, se ata zakonisht janë kanë, kanë qenë t'martume edhe me kojshi. E, e kanë vra qatë personin.

Ka pasë shumë raste, se n'mes t'atyne, atë ditën kur është bo fillimi i pajtimeve, e kanë shku nëpër oda, qe isha nisë për me thonë. Nëpër oda m'u taku, me shku te filan burri, te filan familja. Dikush ka deshtë m'u pajtu, dikush s'ka deshtë, se tash p'i del marrja përjashta. Edhe ajo po është ofenduese për... për shembull kërkush s'ka pasë qejf me thanë, ose edhe une sot, plakë jom edhe nuk du, nuk ia lejoj vetes atë komoditet, "Po shkon me dikan tjetër tu e pasë burrin". Po, mendjelehtësia e bonë ata.

E janë shku qeshtu shpi m'shi. Janë shku i kanë lutë pleqnarët e katunit. I kanë thirrë niherë si n'takim, me përgatitë terrenin, se me dalë aty... 50 mijë vetë kanë qenë atë ditë kur është majtë pajtimi i gjaqeve qatje në... te Verrat e Llukës. Edhe sa herë vike, vishin ata e lypshin. Vishin, janë mytë tu ardhë, me makina prej Pejës, prej Raushiqit, pi Deçanit, pi Skivjanit. Vishin m'u taku, "Qysh p'ia bojmë?" U mbledhshin, e diskutojshin, e analizojshin qysh me gjetë mënyrën ma t'përshtatshme. Edhe murrën qëndrim qe këto femnat, çikat, studentet, me shku me hi nëpër gra, nëpër familje, m'i tregu qe, "T'fillojmö, po dojmë me fillu, a p'e shihni qe po don me shku populli, kqyre çka po na bojnë shkijet, kur na duhet m'u lidhë, kqyre çka po na bojnë ata, e na n'hasmëri." Ata kanë qenë n'hasmëri me fqiun t'a zamë, me burrin e motrës, me djalin e axhës. Ato e kanë ditë mrena qysh i kanë ato punë. Edhe i kanë bind gratë. Gratë mandej... me ni anë kanë shku gratë te gratë, burrat i kanë thirrë nëpër shpia ku i kanë pasë odat nëpër fshatra. Edhe janë shku burrat, ka pasë plot aktivista qì jonë shku.

Edhe kanë vendosë. E kanë bo listën, kanë punu këto çikat. U kanë edhe njo Ajshe Qorraj, ajo është juriste tash. Edhe ajo ka qenë. Kanë qenë plot. Qeky dekani i Mjekësisë, i Mësuesnisë, Ethem Çeku. Sa herë u ardhë qetu. Sali Cacaj. Ka pasë... këtu tanë kohën kush s'ka ardhë, kush s'ka ardhë. A vishin me kamerë,

qyky Sali Cacaj, me kamerë. Mandej Gani Ibërdemaj. S'po m'binë ndërmend tash. Edhe kanë vendosë qe m'u mbledhë. E kanë lajmëru, ky [Zekerja] ka nejtë nja dy javë ditë në Deçan, në Strellc qaty, në Deçan.

Erëmirë Krasniqi: Me studenta.

Resmije Cana: Me studenta jo, po me njerëz, me aktivista, me fshatarë, për me organizu pajtimin. Edhe kanë lypë leje prej organeve, është deshtë me lypë. Kur u bo atë ditë me 1... ka qenë me ni... ditë e Bajramit, si ujë kanë shku.

Erëmirë Krasniqi: N'cilin vend?

Resmije Cana: Qatje te Verrat e Llukës. Kur vishin, e lypshin, "A është profesori aty?" Thojsha, "Jo." Une s'e disha, tash pse me t'rrejtë, nuk e disha a është Verrat e Llukës. Po ajo nuk mahet, nuk përsëritet kurrë. Sa është toka me njerëz, nuk përsëritet ajo ngjarje qysh është zhvillu. Këta janë veshë, parëz që i përmena, [si] ata shkenctarët, shkrimtarët e patriotët t'ma hershëm, Sylejman Vokshi, Idriz Seferi, këta qe janë mbledhë. E këta janë mbledhë nisoj sikurse atë ditë kur janë mbledhë Ismail Qemajli. Janë veshë me kësia...këta n'katun e kanë organizu m'u veshë me veshje kombëtare, me kuaj, me ato komtë ku i kanë vnu [zbukurimet], se na i pamë përpara... me veshje, me plisa, me flamuj. Domethonë, ke vdekë për s'gjalli, qaq që ka qenë emocionuese.

Vishin e kalojshin, ai qe ka qenë Drini, nifarë lumi, e shkojshin me ato duçtë e kualëve, ato jelat qe ia kanë vnu për zbukurim. Këtu n'kry gjithfarë lule, gjithfarë mjete zbukuruese, po krejt kombëtare. Edhe defilunë kah publiku. Une qatë ditë jomë dalë, jom shku, se s'kom shku kurrë. Kur jom ardhë [në shpi], kishe janë hi hejnit. E kishin pasë bo nifarë mbështjellje. Kanë ardhë, e kishin pasë vnu naltë ni inçizusë.

Erëmirë Krasniqi: Përgjusë?

Resmije Cana: Po, përgjusë. Edhe...

Erëmirë Krasniqi: Sa mijë njerëz kanë qenë [te Verrat e Llukës]?

Resmije Cana: Përmi 50 mijë njerëz kanë qenë atë ditë. Nuk mahet menë çfarë... as ushtria s'i ka pritë, as policia. Kur ka... sa filloj, kur ka ardhë ni tenkë përpara publikut. Domethonë, jep me kuptu qe, "Na këtu jemi". Qe asi e kom atë fotografinë, s'po di me gjetë, desha me iu tregu, kur s'di gjo, ky [Zekeria] për ni moment e hoqë setrën, e dulë përpara, tha, "Gjujël!". Ajo me atë tytën e tenkës bojke herë knej, herë ka publiku, herë ka këta njerëzit qe ishin ulun n'binë, herë ka na, herë ka rruga. Une thashë shkoi, po ka pasë marrë leje, ka lajmëru n'organe qe atë ditë nuk ka me pasë kurgja nacionalise, mirëpo ni takim gjithëpopullor.

Aty u mbajke takimi, aty dilshin njerëzit e folshin e kallxojshin për kend po falë, qysh po falë. Kangë, vjersha, program shumë i veçantë ka qenë. Knena n'hymje t'Deçanit ishin konë dalë policia. Kush po vjen tashti aty, rreh - ktheh.

Erëmirë Cana: Çka ndodhi me burrin e jujë?

Resmije Cana: E mandej, burrin tem edhe Antonin edhe grunë e Antonit... na murrëm m'u kthy kur e murrën [ato]. Kurgja, atë ditë u kry. Ata e lanë [të lirë], u kry.

Erëmirë Krasniqi: Çka ndodhi me tenkun, kështu?

Resmije Cana: E me tenkun kurgja. Veç sa m'i kallxu, se aty n'atë tollovi ai... hala s'ishin pjekë kushtet, s'kishin marrë aq forcë ata me dalë me vra njerin. Se ai [Zekerja] ka shku, ka lypë me komanderin e policisë, me komandantin e policisë t'Deçanit, qe ka me qenë ni pajtim. Ajo veç ni takim, ni program. Edhe ata ia kanë aprovu. E jo, nuk i bonë kurgjo. Mirëpo kur u bo terri, kur po vinë po kallxojnë, "Kuku i mytën". Ata tu dashtë tash tu ardhë, tu e rreh popullin. Edhe i kanë kthy, s'i kanë lonë me ardhë.

Erëmirë Krasniqi: A iu kujtohet sa pajtime t'gjaqeve janë bo?

Resmije Cana: Nji mijë e katër qind.

Erëmirë Krasniqi: Atë ditë?

Resmije Cana: Qatë ditë janë bo. Kur nisëm tash na m'u kthy, na dulen policia. Ishim me makinë tonën, burri jem i grahke. Ishte Antoni, edhe unë me grunë e Antonit përmbrapa. Dulen e na nalën. Neve na... (qeshet) neve na morën me makinë na prunë n'Prishtinë, ata dy i nalën n'Deçan, n'bisedë informative. Atëherë ka qenë aktuale ajo. I nalën edhe i kanë majtë dej n'dymbëdhjetë t'natës. Mandej dikur ma vonë këta... plot kishte aktivista, plot aktivista. Kanë pritet një dy-tri vjetë. I kanë marrë, kur i kanë lëshu i kanë marrë i kanë pru këtu. Ishte diku kah dymbëdhjetë a një e natës. I kanë lëshu pa kurgja hiç. Qaq, veç sa pakëz me dezorientu popullatën. Qeshtu qe.

Pjesa e Katërt

Kur u kry te Verrat e Llukës, mandej fillon n'krejt Kosovën, nëpër fshatra u majke pajtimi i gjaqeve. Njeni prej atyne ka qenë edhe n'Prishtinë. N'shkollën "Zenel Hajdini" është majtë ni tubim madhështor. Barëm aty është Fusha e Pajtimit, diku kah medresja, te shkolla, te medresja, te Hani i Dilit. Qaty n'medrese ka qenë. Se na patën thirrë, kafe qitën e kështu, nejse, s'është me rëndësi.

Erëmirë Krasniqi: E sa raste u adresunë? Po menoj, sa gjaqe?

Resmije Cana: A gjaqe, nuk e di. Ka pasë shumë raste, n'tonat. Secili... fillunë mandej këta e bonë nifarë projekti: e ndanë që secila pjesë e qytetit me pasë me ni vend qe e caktojnë për m'u tubu, qe mos m'u enë njerëzit. U duke me shku larg, kështu që me qenë afër, qai kuart, qajo anë. Fshatrat e qasaj ane janë mbledhë n'shkollën "Zenel Hajdini". Mandej ka pasë në Malishevë, ka pasë në Has. N'Zym ka qenë, kom pasë n'Zym. Mandej përvëç këtu ku ka qenë në rrëthinë, qe thashë ma shumti t'organizume, qe ka pasë ma shumë, u mbledhshin me ni vend ma t'madh qe me shfrytëzu rastin për shkak të largësisë.

Erëmirë Krasniqi: A u përdorke Instituti Albanologjik hala si vendtakim?

Resmije Cana: Po, vazhdimisht aty janë taku. Kur s'e gjejshin aty, vijshin këtu. Ja pritshin ditën, u shetitshin ku kanë mujtë. Ka pasë shumë bashkëpunëtorë. Mandej, ku u bonë? Qe, pasna harru ku u bonë ato pajtime, n'Has... n'Gjonaj. Ja kanë pasë dhonë nifarë veshje kombëtare. I kom kallë, m'u kanë kallë.

Erëmirë Krasniqi: A ishte ai n'terren tanë kohën, burri yt?

Resmije Cana: Tanë kohën. Kurrë s'ka metë n'shpi. Mandej kanë fillu n'Shipni, fillunë m'u pajtu. Edhe atje janë pajtu, ka ana e Malësisë t'Gjakovës.

Erëmirë Krasniqi: A është kjo '91, a atje ma vonë?

Resmije Cana: Ma vonë, atje ma vonë.

Erëmirë Krasniqi: N'cilit vite?

Resmije Cana: Mandej ka qenë n'Suedi, n'Norvegji, n'Gjermani, n'Zvicër.

Erëmirë Krasniqi: Edhe n'Amerikë.

Resmije Cana: Edhe n'Amerikë. Dy-tri herë ka qenë n'Amerikë. Ni kohë ka qenë...

Erëmirë Krasniqi: Bashkëardhetarët atje i kanë pajtu?

Resmije Cana: Po, bashkatdhetarët. Edhe kanë ndihmu shumë bashkëatdhetarët tonë. Edhe kudo qe janë, n'Zvicër kanë qenë shumë aktivë. Shumë kanë ndihmu për popullatën. Kanë pru, kanë qitë anëtarësi. Mandej qe kanë metë këta pa rroga. Kanë qitë jashtja shumë, kanë dhonë. I kanë pasë qendrat ku m'u mbledhë. E ka pasë ftesa, tri herë ka qenë m'duket n'Amerikë.

Erëmirë Krasniqi: Kush e ftojke? Se une p'e di qe bashkëatdhetarët, po a e ki najkon, emër?

Resmije Cana: Jo emër, po... është, ka qenë Tom Llantoshi këtu kur ka ardhë. Mandej i thirrke Shoqata "Vatra". N'Kroaci ka qenë disa herë. Mandej kur u bonë helmimet... s'po di tash kur u bonë helmimet, a p'e sheh, s'po di me u kthjellë. E qe thashë, tash prapë duket m'i kthy, e ka marrë... nejse këta p'ia kallxoj për eh, m'i pasë. U deshtë m'i çu mostrat n'Zagrab, i kanë çu.

Erëmirë Krasniqi: T'asaj substancës?

Resmije Cana: T'substancës narkotike qe e kanë përdorë ata. Edhe shkoi djali jem, qyky Liraku me ni shok t'vetin. Ka qenë shumë krizë, kohë e vështirë. Me bo m'i zonë, ata i zishin këtu, ose jashtë. Shkunë deri n'Zagreb, e çunë. Ka qenë n'Sirokë...

Erëmirë Krasniqi: Burri i jujë edhe e ka dokumentu krejt helmimin, a po? Për atë arsyе edhe djali i jujë ka shku.

Resmije Cana: Po, e ka dokumentu. Edhe ka folë qyky Zekë Sinanaj, e ka bo ni emision. Edhe atë natë dulë, s'di qysh ke ai emisioni... "Kontakt", a s'di qysh. E dulë e foli te spitali.

Erëmirë Krasniqi: Domethanë ai e ka dokumentu krejt këta, edhe paska edhe dokumente tjera t'cilit janë n'RTK?

Resmije Cana: Po.

Erëmirë Krasniqi: N'rregull.

Resmije Cana: Ka edhe n'RTK.

Erëmirë Krasniqi: Çka dolën rezultetet e asaj substance?

Resmije Cana: Dolën rezultatet qe është substance qe kanë bo për...

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë helmuese?

Resmije Cana: Helmuese, po helmuese ka qenë. Po ata serbët thojshin, "Jo, kjo nuk është kurgjo. Këta izigravaju, po aktrojnë shqiptartë". Mandej e kanë çu me shkrim, e kanë pasë.

Erëmirë Krasniqi: Serbtë?

Resmije Cana: Këta e kanë marrë, po, me shkrim e kanë lypë edhe ia kanë kthy. E kanë pasë çu jashtë, pi Zagrebit mandej diku jashtë e patën çu, qe me verifiku a është aktrim, a është... po helmim. Po badihava, me kon m'u marrë vesh?

Erëmirë Krasniqi: Ku kanë përfundu qato dokumenta? A e ka bo burri i jujë naj... a e ka ndërtu naj rast kundër?

Jeta Rexha: A e ka hulumtu ma shumë qatë...?

Erëmirë Krasniqi: A e ka paraqitë para naj trupi gjykusë, a?

Resmije Cana: Po, po, e kanë paraqitë. I kanë paditë, po. E, qysh u kanë ata, nifarë gjykate qe ka pasë çu? N'Zvicër, a nuk e di kah. Po thomë, i kam pak si nëpër mjegull, se janë harru ato.

Tubimet qe i kanë majtë me bashkëatdhetarët, i ka çu fotografitë. I ka edhe fotografitë poshtë. S'di a ia kom kallxu? Nja dy a tri i kom pa qaty qe janë, tu qitë me durë e me komë prej... qe iu kanë dhonë helm. Tash s'po di qysh iu kanë dhonë. As s't'jepke afat, a e din, asi marramendëse ka qenë situata. Knej i bishin ata me kerre, u shike...

Erëmirë Krasniqi: Me ndihmë t'shpejtë?

Resmije Cana: Me ndihmë t'shpejtë... jo me ndihmë t'shpejtë, po edhe njerëzit privatë ngajshin, civilë, m'i pru.

Erëmirë Krasniqi: A është kjo naj punë fillestare e KLMDNJ-së qe e ka bo burri i jujë?

Resmije Cana: Kjo n'kuadër.

Erëmirë Krasniqi: A është fillimi i Këshillit?

Resmije Cana: Jo, Këshilli edhe ma herët ka punu.

Erëmirë Krasniqi: Çka ke dashtë me thonë? A është n'kuadër t'Këshillit krejt kjo punë?

Resmije Cana: Edhe kush u rreke, u lajmërojshin. Vike këtu i fotografojke. Shkojke n’Institut, nuk e gjojshin n’Institut, vishin këtu. Mandej krejt i ka pasë shënimet. Qe une e harrova ata, me t’ë pru librin qe e ka formu Këshilli. E ka themelu, për t’drejtat e njeriut

Erëmirë Krasniqi: A ka qenë familja e presekutume për shkak t’këtij aktiviteti?

Resmije Cana: Jo, interesant, jo. Edhe ata nuk e kanë maltretu qaq. Vetëm me ni rast: niherë, e patën marrë kur kanë qenë... kur ka ardhë Tom Llantoshi, kur ke mshelë televizioni, u dalë para televizionit. Mandej kur kenë mshelë fakultetet, ka dalë te Falulteti Filozofik. I kanë njekë studentat, kanë ikë. Edhe këtu popullata. U konë dalë ky... ni mjek... ai, e kishin pasë përgjakë. Ka qenë Vetoni, me gjithë këta janë dalë para policisë kur e kanë mshelë televizionin.

Erëmirë Krasniqi: Zoti Zekeria ka dalë?

Resmije Cana: Po, po.

Erëmirë Krasniqi: A ka majtë naj fjalim?

Resmije Cana: Ka majtë fjalim. Edhe këtu para Fakultetit Filozofik.

Burrin tem e ka mbrojtë *State Department* amerikan. Edhe këta... mandej këto partitë. Ka qenë ni shtab i Jabllanicës, këtu. Aty ka qenë përgjegjës Ramushi. Mandej kur vrajshin ushtarë, ni Besim Drecaj u konë, ni polic, e kishin pasë vra. Ky është shku. S’like vorrim pa shku, s’like ven. Qitu e kanë pasë pru njonin qe e kishin pasë gjuitë prej... për shembull t’ë zamë prej atyhit, ka qellu ni mur. Ai ka qellu, ai personi mas murit. Këta i kanë mëshu me automat, krejt i kishin pasë hi n’sy ato spirrat e gurëve, e i hjeke. I ka pasë durtë e përgjakne, i heke me thojë prej syve. Këtu e kanë pru me plaf, qetu n’qatë dhomën.

Erëmirë Krasniqi: ’97 kjo, a tetë?

Resmije Cana: Po, ’97-98. Mandej e kanë pasë pru qetë... qysh u kanë ai djali, Jetullah Desku. Në faqen e “Zërit t’Rinisë” barëm e ka pasë pru, e ka pasë qitë n’shtyp, qysh ia kanë pasë kepë trupin, mas obduksionit. Edhe thojshin, “Jo, se ka bo vetëvrasje,” a këta tu e rreh, tu e maltretu atje. Mandej i patë dhonë urdhën aktivistave m’i çelë. E qetu e kanë pasë pru pi *Nova Gorica*. U kanë ai djali ushtar, e e prunë t’vetë, janë shku me e marrë. E, e prunë t’vetë, “Këtu n’hymje t’Prishtinës,” patën thonë, “jemi”. Erdhën, edhe e prunë këtu neltë. E shtinën n’shpi. S’di qysh kemi shpëtu, po t’kallxoj.

Erëmirë Krasniqi: N’cilat vite është kjo? N’kohënat e luftënavë...

Resmije Cana: Jo, para luftës. Para luftës.

Erëmirë Krasniqi: Jo tonën, po po mendoj lufta n’Bosnje, n’Kroaci, kur këta kanë shku... kur i kanë marrë me zor shqiptartë me luftu atje. Mandej veç ia kanë kthy trupat, a për cilën?

Resmije Cana: Jo, po ky ka qenë n’shërbim ushtarak. Se mandej ky në tubimet qe i majke thojke, “Mos iu përgjigjni shkumjes ushtarë. Mos shkon!” Mandej u çunë ata, ikshin, kush kah mujke. E këta masanena kur i bishin, “Jo,” thojshin, ia kanë dhanë atë fletëlëshimin, “u konë i smutë psiqikisht, e ka bo vetëvrasje”.

Thojke, "S'është e mundun. M'i çelë arkivolet". E, e prunë nja, qetë Jetullah Deskun. Nja katër vetë e prunë arkivolin këtu, me asi t'bllobume, e murrën me atë... çka osht' ajo, me...

Erëmirë Krasniqi: Saldusë, a?

Resmije Cana: Me qasifarë saldusë diçka, e e prenë këtu, e çelën. E ka bile fotografinë, poshtë e ka. Qeshtu krytë {e ulë kokën në të majtë}, e çelën. Thojke, "Është... kurrë mos e pranoni pa i çelë". E mandej iu ka pasë dhonë urdhën qe kur i thirrshin familjet, iu thojshin, "Lu bimë na atje n'vend, n'vendlindje iu bimë".

Erëmirë Krasniqi: N'shpi, te ju ka ndodhë?

Resmije Cana: Qikjo, njani prej atyne n'shpi ka ndodhë. A mandej kur lajmërojshin qe ka vdekë ushtar... ke nifarë periudhe qe i vrajshin ushtartë, edhe thotë, "Mos i pranoni! Kur t'vinë ata qe thojnë 'Po dojmë me iu pru,' thujë 'Nuk keni nevojë me n'a pru ju. Na dalim i presim, ju s'keni nevojë'". Se lypshin ata me marrë pjesë n'vorrim. Demek, "Edhe po t'rrehi, edhe s'po t'la me kajtë".

Erëmirë Krasniqi: A po t'kujtohet cili vit është kjo?

Resmije Cana: Ja, duhet m'u konë aty, po ku m'i marrë tashti. M'u konë me m'i ngri, me m'i lanë t'ngrita. E i patë thanë... qeta e maj n'menë se e patë pru këtu, tha, "Çelni arkivolet edhe mos i pranoni me ardhë, 'Po dojmë me ardhe m'i pa'". Bile ky Jetullah, ky Desku, ka pasë [emrin] Cen Desku. Osht' është ajo libra pér...

Erëmirë Krasniqi: Zotëni Cana i ka dokumentu krejt qeto raste, a po?

Resmije Cana: Po, krejt i ka dokumentu. Ka hapë ekspozitë n'Amerikë. E aty është dashtë me qenë shumë bashkëpunëtorë. Krejt e ka dëshmu, ka hapë ekspozitë n'Amerikë.

Erëmirë Kransiqi: Kjo është '97? N'cilin vit duhet me qenë?

Resmije Cana: N'tërrt viti.

Erëmirë Krasniqi: Okej.

Resmije Cana: P'i fshinë mo koha.

Erëmirë Krasniqi: A është para luftës?

Resmije Cana: Para luftës. Po, po, para luftës. Edhe para luftës ka qenë n'Amerikë, qe e ka thirrë Shoqata "Vatra".

Erëmirë Krasniqi: E qysh janë pajtimet n'mërgatë? Qysh ndodhshin pajtimet n'mërgatë? A e ki naj informatë? Qysh janë organizu?

Resmije Cana: Qashtu janë mbledhë nëpër... i kanë pasë këta, i kanë ato zyret ku rrishin, ku rrinë, ku dalin takohen mërgimtartë, qaty e bojshin.

Erëmirë Kransiqi: E, a ndodhshin, a hishin n'hasmëri atje, apo u bartshin këto prej Kosovës?

Resmije Cana: Jo, ata pi këtuhit janë bartë, janë shku me hasmëri mes veti. Kur u bo mandej, u ushqeqjshin, u influencojshin prej tyne, se dojshin me hekë atë barrë t'rondë, atë t'keqe. Se ata kanë nejtë, atje janë shku i kanë vra, jashtë. Qe këtu t'Shipnisë, qetash njoni e vau qe kanë qenë n'gjak. Dhe ata mandej, t'tonë kontribojschin n'atë mënyrë qe m'u maledhë, me gjetë momentin m'u pajtu, se u shlirojshin. Ai dil, ai ruje, ai hasmi ruje. Se tashti ata u nishin si edhe t'nënçmumë. Edhe iu ka marrë fytyrën, edhe mandej dilshin m'i vra, kishe nime u konë. Ajo n'mes rreshtash. Kishe nime u konë qe e ka vra për megjë, a përvadë, a hamom. E i ka metë vadës edhe megjës. E dilshin ato, "E fali gjakun e t'vetmit vëlla," "E fali gjakun e djalit," vëllau i sa motrave, dilshin ato në kësishne, me mikrofon, qatje qe ishin. N'Rahovec ka pasë. Une jom shku qetu te Verrat e Llukës edhe n'Gjonaj. Edhe kah Gilani janë majtë pajtimi.

Erëmirë Krasniqi: N'emër t'çkafit e falshin gjakun? Qysh ka qenë ajo?

Resmije Cana: N'emën të rinisë, edhe t'kombit shqiptar. N'emën t'riniqë kosovare, motrave, nanave kosovare shqiptare. N'emër t'Këshillit najherë thojke. N'emën t'ketyne burrave qe janë angazhu, e falim gjakun e djalit e, t'vëllaut e, t'fëmisë e. Po m'kthehen ato, po s'po kom, i ka fshi koha. Se kanë qenë shumë trishtuese, shumë emocionuese. Dilshin me ato musteqet, e me ato veshjet, t'bardha t'veshne, "E falim gjakun e t'vetmit djalë," e t'vëllaut e, t'mixhës e...

Erëmirë Krasniqi: A dilshin edhe nanat, edhe?

Resmije Cana: Po nanat e, motrat e, nanat. Nja dy-tri motra i maj n'menë, "E fali gjakun e t'vetmit vëlla," "E fali gjakun e djalit n'emën t'jujin e t'riniqë kosovare, e motrave shqiptare". Aq kanë qenë emocionuese, po nuk kemi marrë mend, nuk kemi marrë mend, me qëndru, me thonë, "S'bojmë ma kështu". A po t'vjedhë, a po t'rrenë, a po t'mashtron, pse i kanë bo këto? Po badihava, nuk lanë. Sa u bo mirë kur ja nisi lufta, kur u duke me dalë te tanë, thu ti jemi motra e vëllazën. Shkurt ke ai emision.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë lufta për juve? Çka keni bo gjatë luftës?

Resmije Cana: Qitu kemi nejtë, n'shpi. Ky i vogli ka qenë n'Vjenë. Ai dojke me ardhë. Ky ke dalë, burri i jem, ke shku n'kufi atje, kah dilshin refugiatë. Dilke qetu n'rrugë, bile janë kanë ardhë policia, "Pse, çka po del? Pse ti p' i kthen njerëzit?"

Erëmirë Krasniqi: Qysh, dilke i nalke njerëzit qe ishin [në rrugë]?

Resmije Cana: Po, dilke iu thojke, "Mos shkon!" (qeshet). Para nja dy-tri dite qikjo kojshikja m'tha, thanë, "Ku po shkon?" e, e di n'kufi atje. Bile po thotë djali i jem, "Mamë, çka paska baba?" queshtu bojke, {i hapë duart}. "Kthehi, kthehi, kthehi n'shpija t'juja. Nuk është vendi i jonë, shkon n'vend t'jujin. Pse i keni marrë n'qafë rrininë, e fëmitë e?" me beba, me pleq, zhagë i ngrehshin. Skenë ma e rondë, çka po don me lonë shpinë? Iu kanë dekë njerëzit rrugës. Nonat i kanë bajtë me karroca. Qetu janë ardhë, me karroca shkojshin n'stacion t'trenit.

Erëmirë Krasniqi: Juve a iu kanë qitë prej shpisë?

Resmije Cana: Jo, jo, s'jemi dalë. S'jemi dalë.

Erëmirë Krasniqi: Po as nuk ka ardhë kërkush?

Resmije Cana: Jo, nuk ka ardhë. Nuk ka ardhë. Këta kojshitë, do janë dalë, do s'janë dalë. Këtu milicia ngajke. Po dikur iu hargju atyne benzini, metën pa benzinë. Edhe tu kalu qetu, tu u ngjitë, se i kanë pasë banesat anej kah Bregu i Diellit, krejt milicia. I kanë qitë ata t'Bregut t'Diellit, krejt i kanë qitë. E këtu ku kish' t'përzinë, nuk vishin, ku kish' edhe shqiptarë, edhe shkije nuk hishin, se u tutshin çka p'i gjanë... se iu harxhu benzini. Mandej dulën tu u ngjitë përpjetë, ai ni qen kur i ka pa këta tu kalu, ka bo "Ham," (qeshet) polici u frigu, e ka zgatë pushkën, e ka vra qenin. Se s'ka pasë... qashtu qe.

Ndonji skenë po m'kthehet. Pak, pak, po m'i ka brehë koha, edhe apet ma mirë, veç m'u tranu, veç mos m'i regjistru. Megjithëse krejt harresa p'e bonë t'vetën. Koha, streset, tonë jetën. A iu thashë parëz? Tutu prej policisë, tutu pi atij, tutu pi këtij, po t'i brejnë. Harresa, eh...

Erdhën mandej dy policë këtu. Ai burri jem ish' atje. S'ka nejtë, tanë kohën ka nejtë nëpër shpia. E ka majtë kush e ka njoftë. Nja dy javë ditë nuk u konë hiç n'shpi. Dulën këta, qitshu, pi shpiave, i përzishin popullin.

Erëmirë Krasniqi: A ish' burri yt n'listë të Armatës?

Resmije Cana: Jo, jo, jo. Une po t'thomë se ka qenë... une i thojsha, "Mos shko". E këtu, n'Jabllanicë qe t'hashë, ka Gjakova kur t'shkojsh, ka qenë shtabi i Ramushit, edhe ka o shku, se na shiptartë...

Erëmirë Krasniqi: Kjo para luftës, a qysh?

Resmije Cana: Po. Na shiptartë, si bagëtia jemi, qe si une sot qe pi shoh vetin (qeshet), pa kompas, pa busullë. Ka qenë krahu i Ramushit, ka qenë krahu i Tahir Zemës. Kur diç burri jem, erdhën e po thojnë, ni person, "A doni me vorrosë me nderime si Azem... Tahir Zemaj?" Tahir Zema ni krah tjetër, për qata janë përla, janë cakërru mes veti, edhe tash formo ni rrjet t'vetën.

Erëmirë Krasniqi: Mrena ushtrisë, UÇK-së?

Resmije Cana: Po, mrena ushtrisë. Tahir Zema. Mandej ka qenë ky Krasniqi, Ahmet Krasniqi. O shku pi këtuhi atë ditë n'vorrim t'Ahmet Krasniqit. Kur ka shku, i kanë çu për ushtrime, tash p'i kthej trakën po me data nuk po di me t'a saktësu. I kanë pasë çu ni grup me mësu me bo ushtrime, diku në Fushë Krujë, a s'di ku me ni fshat, ushtarët qita, kush ka dashtë me shku n'UÇK. Kanë mbledhë me lista, kanë formu lista, edhe janë mbledhë, janë shku atje. Çojshin, ka pasë çu plafa, barna, kremna, detergjenta për m'u la, se thojke, "Kishin zanë morra". Me nifarë hoteli, nifarë shkolle. I kanë pasë çu këta ushtrartë tonë jashtë, n'Shipni. Edhe qaty i kanë majtë, tashti sa kanë ditë e, kanë mujtë e, sa kujt i ka kushtu.

Kur tash p'i kthej kohën, p'i di se kurgja, as si kanë kqyrë, veç taksirati i qatyne t'rive. Se njoni i ka marrë, 90 për qind i ka marrë për veti, tjerat i ka çu kishe atyne ushtarëve. Thojke, "Po shkojmë m'i kqyrë, m'i çu ushqim, m'i çu veshmbathje, detergjenta, zhuga iu kish ra gru". E tash kur p'e bajë shejën e barazimit me sodit, p'i di qì veç qì s'i kanë lonë cullak. Qato sene i kanë marrë, i kanë çu n'shpi t'vetë.

Erëmirë Krasniqi: Çka ndodhë n'qatë farë varrimi? A ndodhë naisen specifike? N'varrimin e Ahmet Krasniqit, ku ka shku zoti Zekeriaja?

Resmije Cana: Jo, atje n’Tiranë e kanë bo varrimin, se ai ka qenë ushtarak kolonel. Me gradë t’kolonelit. E kanë vra qita t’tontë e kanë vra, prapë s’po del. E kanë vra këtë Xhemajl...

Pjesa e Pestë

Ka qenë tu shku në takime, kur kanë bo takime, kur kanë pasë tubime, ky ka thonë, “Nuk është koha tash t’përshëndesim me grusht. Tash na nuk kemi nevojë t’kthehem i kah Lindja, kah Rusia, kah Kina”, edhe këta t’Enverit kanë përshëndetë me grusht, “na kemi nevojë m’u kthy kah Perëndimi, kah është kultura, kah është civilizimi”. Po m’doket qe p’ë ni ka po folë. Edhe tash këtyne dikuj s’i ka ra, edhe mu nisën me ngajtë ushtria [idiomë], e Çombës, thotë... edhe tash dikujt s’i ka pëlqy, se kanë qenë marksista-leninista, ki pasë qitu n’UÇK. Ki edhe n’parlament, i ki sot t’vendosun. Edhe ka t’shkon ai, s’di a iu ka ra me ndigj për familjen Havolli, Baholli, Baholli. Ai dilke me kerr, me makinë tonën, burri i jem ngajke. Pra vike najkush, si une me thonë, “Ku ki me shku sot? Qe ku e ki shoferin, edhe makinën e ki t’mushne me benzinë ku ki me shku”, se e ngjishin menihere, si dilshin e ngjishin. E këtu, n’këtë rast, u kanë tu shku me ni makinë t’këtij Bahollit. Këta Bahollit janë qe ndreqin kerre, shesin kerre. Qetu... aty e kanë te, ku shiten...

Erëmirë Krasniqi: Te pazari?

Resmije Cana: Te pazari i kanë dugojtë. Janë familje pasanikësh, po janë edhe familje patriotësh. Edhe ka ardhë njeni pi atyne djemëve, i ka thanë, “Profesor, qe merre kerrin tem. Shko ku ki nevojë gjithë ditën”, edhe shoferin. Nejse, ky e ka marrë. Tu shku rrugës, e kanë nalë qaty, n’qatë shtabin për t’cilin t’fola përpara. E nalin, edhe ata dalin t’veshun me maska. Thotë, “Çka u bo?” “Dil!” Edhe p’ë marrin p’ë shtinë n’shtab. Ai thotë, “Pse, fol bre burrë? Fol shqip, pse po fol serbisht?” Tha, “Folshin ni serbishte...” tha, “I thashë: une di serbisht se e kom kry shkollën serbisht. Fol shqip, heke atë maskë. Pse po mfshifesh? A je burrë? A je luftëtar? Hike maskën t’shoh me konë kam punë.” Tha, “la nisën gë gë gë, e m’morën e m’shtinën n’shtab”. Qaty t’Ramushit. Edhe aty ka qenë ni korrir qe o sjellë. Vike këtu përditë.

Erëmirë Krasniqi: Shpiun?

Resmije Cana: Po, shpiun sigurisht. Edhe ata... s’di a t’ë kom tregu, te Walkeri ku ka qenë, ku i kanë vra ata, n’Reçak. E, e shtinë mrena këta. Ia marrin kerrin. Tu u kthy, thotë, “Unë nuk kom me kend me bisedu,” edhe merr me dalë. Tu marrë me dalë, këta i turren, “Kthehu! Kthehu!” Qellon... tashi ka gjithçka, qellon ni gjakovar, n’periferi t’Gjakovës shpinë, edhe e çelë derën [e veturës], edhe e shtinë mrena. Thotë, “Shpejt profesor, hin.” Tha, “Deshë m’kapën”. Ai m’ka tregu, mandej i ka tregu burrit t’motrës n’Gjakovë. Ish konë çatrallisë syve, se kanë dashtë m’i kapë m’i shti mrena m’i mytë. Pahiri iu ka rrëshqitë prej durve, edhe o ikë.

E ka shti qaj personi n’makinë t’vetën edhe o shku n’Gjakovë. Ka thonë, “Për pak”. Ha, ata i kanë thonë, “Grahi kerrit, grahi, se t’ë bojmë ma zi ty, çka kemi pasë n’plan këtij me ia bo”. Ai njeri ish’ konë frigu, ka nisë me asi, bile ka thonë, “Ia kom ngre komtë zhag profesorit me ikë pi tyne,” edhe ia kanë marrë qatë makinën, qe po thomë ky Baholli ia ka dhanë.

E mandej kur erdhi, po kallxon, m'thirren, se shkojke kah kish' nevojë, e po kallxojnë qe ia kanë marrë ni kerr. Kur u kthy n'shpi mas nja dy dite, une p'i thomë, "Kuku, marrja e Zotit, çka ka pasë ai njeri faj? Qynahi i Zotit me ia marrë kerrin". Edhe erdhi ai, "Zojë," tha, "m'fal, nuk du me t'i pa lotët," tha, "unë ia kom dhonë kur s'kom pasë, une..." m'falni n'sprehje, po përgjigjna banale, "kur s'kom pasë une për veti forcë me dalë, për mu kerri ka peshë sa ni fije e flokit. Une ia kom dhonë këtij qe ka mujtë me dalë. Une jam paraqitë qyqan. As mos e banë n'pytje atë, mos e banë bisedë. Une ia kom dhonë vetë". Thojsa, "Pse me ta marrë ty?"

Erëmirë Krasniqi: Ky i Bahollëve?

Resmije Cana: Po, Baholli është. Është... Baholli. Është familja Adem Bahollit, edhe ky është... shet makina t'mira. Nalu, s'po m'kujtohet emri i tina. M'kujtohet ndërkohë, si Nazmi Zhushin qe u kfilla. Nejse, është familja e Adem Bahollit.

Mandej vlenë edhe m'i përmendë... edhe n'Reçak qe e thamë, edhe atje kanë shku. Mandej ka ardhë ni shpiun, qe e qujë shpiun me plot kuptimin e fjalës. Atëhere janë kanë n'modë çerapat e bardha, ai e kishte pasë veshë ni jaknje t'rrryptë, edhe "Profesor," thotë, "hajde se du me t'marrë, ku ki nevojë me shku? I, a qetu..."

Erëmirë Krasniqi: Kush ka qenë ai, a ia dini emrin?

Resmije Cana: Jo, s'ia di emrin. Po, ai ka pasë me shku se ni mramje përpara, u konë qaty ka Reçaku, ka Gilani. "E kishin pasë hanger," tha, "ni njeri, gru, qentë. E kanë vra, u metë i vramë, s'e ka pa kush. Kush me guxu me dalë? Ishin konë hi qentë, e deri këtu iu kish' bo fytyra me gjak, tu pi gjakun e viktimës". E ndërkohë qeky qe ka qenë, ky ka shku, kanë punu te tanë, ka qenë Niva i Institutit Albalologjik, shoferi i Institutit Albanologjik ka shku me këta. O ardhë e ka marrë, edhe kush e di qysh i ka lidhjet qaj, erdhi e murrë. Ky përmas, ky përpara me qatë shoferin e Institutit. Ky o shku përpara, ka dhonë shejë atje qe po vjen, edhe ish konë rrëzu ni - iu kom tregu nashta, me sa di - ni kamion me banane, tu ra borë.

Erëmirë Krasniqi: A e din vitin e qesaj?

Resmije Cana: Jo, jo. Kur u bo Reçaku.

Erëmirë Krasniqi: Ok, domethanë n'qatë vit.

Resmije Cana: N'qatë vit, po.

Erëmirë Krasniqi: Ajo u bo '98.

Resmije Cana: Po. Po, krejt ka pasë marrë valë, gjithkah. Edhe kur t'afrohen aty...

Jeta Rexha: M'doket n'99-të.

Resmije Cana: '98-99.

Erëmirë Krasniqi: Ok.

Resmije Cana: E, kur t'afrohen aty, qe ni kamion u rrëzu. Ajo u rrëzu me punë t'vetat, qaj qe ka pasë me e pru, kështu për tregti. Këta me këtë *Nivën*, me qetë shoferin e Institutit janë konë mas tu shku, tu shku n'qatë, me fotografu. Edhe ka qenë edhe te t'Reçakut, edhe i thotë... kur dalin policia përpara. Po t'jep me kuptu, budallë n'kofsh, se ai erdhi me i marrë, e ka marrë për me çu n'vepër. Edhe e kanë nxjerrë pi kësajna, pi *Nivës*, edhe atë shoferin, "Parkoje knena," edhe e kanë afro qaty. Tu fry, tu ra borë, tu fry fryma, thotë "Merri, merri, kapi këto". Thotë, "Jo, une nuk jam dalë, s'du me i marrë une këto, s'kom ardhë..." "Merri!" "Unë jam tu shku tjetërkun". "Ja, merri, merri. Shtini n'kerr". Ai ka thonë, "Jo, s'du m'i marrë". Ai bile kallxojke shoferi i Institutit, ia ka afro pushkën te fytyra, "Merri, tha "la afrojke këta, e kapë për krihësh, e afrunë te gajbet e bananeve".

Erëmirë Krasniqi: Instituti deri atëherë ka qenë aktiv, a?

Resmije Cana: Po, po, kanë qenë aktiv. Mas ni kohe shpejt edhe pi Institutit i qitën.

Erëmirë Krasniqi: Po kjo tash s'pe kuptoj, nëse është koha e Reçakut, e kjo është?

Resmije Cana: Reçaku ka qenë me t'parat qi u bo, kanë fillu masakrat qi u bojshin, qe bojshin kërdi nëpër kësi.

Erëmirë Krasniqi: Po a ka qenë i funksionalizumë n'atë kohë Institutit, me veturë e me krejt?

Resmije Cana: Po, po.

Erëmirë Krasniqi: Ok.

Resmije Cana: Edhe mandej ky e ka kapë, ata e kanë fotografu. Mandej mjetet e informimit, gazetarët e asi, "Ky është najfarë banditi se u dalë me vjedhë banane". Mandej ka qenë dalë ajo forja "Cana Banana", s'di a iu ka ra.

Erëmirë Krasniqi: '99-ën, a?

Resmije Cana: Po. Barëm qyky i dyti thojke, "Kuku mamë bre". Shkrujshin, si këtë farë presidenten (qeshet) qe e kanë... shkrujshin, vizatojshin me kimika, me fllomastera. N'Pejë e kishin pasë shkru.

Erëmirë Krasniqi: Ashtu si sllogana?

Resmije Cana: Po, sllogana, "Cana Banana". Edhe e kanë qitë, e qitën n'televizor. Ky hala pa ardhë pi atjehit. Kur hini po thotë, "I gru, qe kom vjedhë banane sot". Mirëpo njerëzit tonë qaç dritë shkurtë, nuk e kanë marrë q... ai zori s'ka kufij. Na tash kollaj mujmë me thanë, "Pse e ka marrë?" po n'moment, shpirti i omël, s'ka llogaritë, po thujë ti atij s'i kish kushtu kurgjo, i kish dhonë ni plum edhe hajt. Krejt Kosova, ai e qitën edhe televizioni.

Erëmirë Krasniqi: I Serbisë, a cili?

Resmije Cana: Po, po edhe i Kosovës, se i kanë pasë shti masat e dhunshme, ti Erëmira. Nëpër t'gjitha: televizonin, n'Ent t'Teksteve, n'Rilindje, n'krejt ka pasë masa.

Erëmirë Krasniqi: P'e di. S'e kom ditë qe ka pasë televizion n'atë kohë, qata.

Resmije Cana: Po, po n'kuadër t'Serbisë.

Erëmirë Krasniqi: Po, ka qenë nashta do orë.

Resmije Cana: Eh, e kanë pasë lanë do orë.

Erëmirë Krasniqi: Po, po, Radio Prishtinën.

Resmije Cana: Qeshtu qe.

Erëmirë Krasniqi: E me konë ka komuniku Këshilli, kur ai burri jujë ka mbledhë dokumente? A e din, m'i plotësu rastet për me tregu çka ka ndodhë.

Resmije Cana: I ka pasë bashkëpunëtorët.

Erëmirë Krasniqi: Ku i ka dërgu? A i ka dërgu me naj qendër tjetër për drejtat e njeriut?

Resmije Cana: Ja vishin këtu ata, i majshin, vishin i bishin. Merrshin shënime, fotografojshin, kur nuk ka qelli për shembull këtu. I ka pasë bashkëpunëtortë, i ka pasë pi Pejës, ka pasë pi Gjakovës, ka pasë pi Deçanit, ka pasë t'Prizrenit. Ky bile, qe m'kujtohet nga, Radoniqi, Mustafë Radoniqi n'Pejë. Mandej Mulla Xhevati i Malishevës. Ai përditë u ardhë. Mandej qyky Cen Desku, me do kusherit t'vetë, vishin. Përditë janë ardhë. Mandej ka qenë ni gru e Cenit, kanë bo lindje, qeshtu nëpër shpia private. Ajo ka dhonë injeksione. Osht' shku n'shab, qe bile, e merr, si ushtare e merr.

Erëmirë Krasniqi: Qysh e kalutë krejt qatë periudhë?

Resmije Cana: Luftën, qetu n'shpi kemi nejtë. Jemi enë nëpër kojshi. Djali i madh shkoi te miqtë e vetë, me fëmi t'vogël. Ky i treti ka qenë n'Austri. Ky s'u nalke, shkojke. Njikohësish duhna t'a falenderoj edhe Adem Havollin. Ai ku ka pasë nevojë, e ka çu. Tash ka vdekë, para nja ni muje.

Erëmirë Krasniqi: Burrin e jujë?

Resmije Cana: Burrin tem.

Erëmirë Krasniqi: E ka vozitë?

Resmije Cana: Po, e ka bajtë, e ka enë ku ka pasë nevojë. I ka vorrosë Jashartë. Ai ka shku rrëthit t'lumit, e nesërit kanë mbërri. Edhe ka folë me policë, i ka thonë, "Qe s'vini deri n'filan dite..." kërkush, krejt ishin pasë ikë: me aktivista, me ç'aktivista. Se di, duhet si forcë mbinatyrore mund ta qujë, se ata kanë pasë armatim, deri n'dhombë kanë genë t'armatumë. Edhe kur kanë dalë, e kanë nalë te Fabrika e Municionit, e kanë nxjerrë pi makinës, edhe i kanë thanë, "Kthehu!" kështu, {imiton mbështetjen me duar për muri}.

Erëmirë Krasniqi: Me t'kontrollu.

Resmije Cana: Me t'kontrollu. Ai nime s'ka pasë me veti kurgja, po thotë, "Gde češ?" ["Ku je nisë?"] "Kod jednog priatelja." ["Te nji shok."] "Pse, šta češ u ova doba?" ["Pse, çfarë lyp kaq vonë?"] "Hajt, znaš da čemo da te ubijemo?" [A e din që kemi me t'vra?] Thotë, "Aii, postaću heroj ako me ubijete." [Ai, do të bëhem hero poqëse më vrani.] Thotë, "U, majku ti twoju Albansku." ["Uh, nanën ty t'Shqiptarit."] (qeshet).

E kanë lëshu. Kur o shku atje, policë tu rrehë, tu njekë gjinë. Tash, kjo si luftë guerile mund t'a qujshë. Faktikisht qashtu u konë. Po krejt kapadai. Krejt fillon historia prej ni personi. Edhe qita udhëheqësat, qita ushtartë qe janë, krejt kjo ka ardhë qe janë përla mes veti, se mos po del ai ma i aftë.

Edhe kur shkon atje, ai thotë, ai komanderi i policisë, qaty i Drenicës, te Fabrika e Municionit, thotë, "Qe se vorrosni deri..." nifarë termini ia kanë dhonë, "deri n'ora qekaq, na e vorrosim". Tha, "Ishin ardhë me bagera, me bullduzhera."

Erëmirë Krasniqi: Qysh e ka organizu atë vorrim? Po menoj, kanë qenë plot njerëz qe janë vra, ka vyjtë me siguri plot mbështetje, ku e ka marrë?

Resmije Cana: Ku e ka marrë? E ka marrë prej Bajram Currit (ironizon dhe qeshet). Edhe me ni hoxhë të Drenicës aty, t'xhamisë. Ai bile kish pasë thonë kur ia kanë dhonë qetë mirënjohnje, thotë, "Une jom konë atë ditë aty kur i ka vorrosë Jashartë". Atëhere çohet ky djali jem i madhi, e kanë bo qatë tubimin, ka thonë, "Jo ju qe keni qenë, po qe une jom djali i tina këtu," tha, se deshti ai me marrë vetë [meritet]. Jonë dalë mandej dikush dikush, se janë shliru pakëz, janë mbledhë burrat. I ka çu ky, ka çu njerëz, ka angazhu. Kur vike...

Erëmirë Krasniqi: A i ka përdorë burimet e KLMDNJ-së? Njerëzore po menoj.

Resmije Cana: Po, po sigurisht. Ata e ngjishin, u konë bo si kali i pesë shpive. Tonë policia e ngjishin, "Pusti, pusti, onaj ludi, onaj Cana, ludi." ["Lëshojeni, lëshojeni, ai i trenti, ai Cana, i trenti."] edhe e çonë e thirrë, aktivizohen, edhe thotë, "Na për dy orë i vorrosim," me kësi qe thashë, me bagera, me tenka, me bagera qe thashë, edhe s'ka këtu mo. Ata janë ikë me gra, me krejt. Mandej dikur e kanë çelë ni derë ma vonë, mas nja dy-tri dite. "U konë metë," tha, "fshati, s'lujke çak, s'lujke mizë." E kanë bo ni formalitet, ka çu fjalë, tash prap po t'a them, osht' ni gjakovare, i ka pru, ka thirrë ata n'Gjakovë. Shumë ka qenë praktik. Ka çu fjalë n'Gjakovë, osht' ni familje, 70 arkivole i ka pru për vorrim. Edhe i kanë shti tonë nëpër arkivole. Edhe janë çu krejt janë angazhu, e kanë rrafshu venin, e kanë bo, tashi po çelin t'pame. I ka thonë, "Me m'dhonë edhe disa ditë afat. Këta nuk janë qejë." tha, "Se masanena u zhdukën policët, s'kish, veç najnja qe rrike kështu, e sa për asi," se e kishin kry punën, tanë ata njerëz i kanë vra, tash henez me vra? Mevlyde Saraqi, është ajo.

Erëmirë Krasniqi: Çka, familja e tyne ka...?

Resmije Cana: Jo, ajo ka ardhë si aktiviste pi Gjakovës, m'u kujtu, me qato 70 arkivole. I ka maru ni familje, i kanë pru këtu, në Drenicë. E ajo është... pi qituhit s'po di me t'kallxu, ajo është sakrificë e madhe me marrë guxim, e me t'ra n'menë ku me shku, tek me shku, edhe i kanë pru ata. Janë ardhë me kamion, qajo ni familje është në Gjakovë. Kanë angazhu plot edhe i kanë vorrosë si njerëz.

Erëmirë Cana: E obduksionin a ia kanë bo, apo?

Resmije Cana: Çfarë obduksioni more, pashë Zotin!

Erëmirë Krasniqi: Kurgja hiç?

Resmije Cana: Çfarë! Qashtu si qentë, veç qe t'kanë leju, [Zekeria] i kish pasë thonë, “*Ljudski da se sahrane.*” [“Njerëzisht të varrosen.”] “Që kjo është nevojë elementare e njerëzimit m'u vorrosë si njerëz. Këta qejë nuk jonë, kafshë nuk jonë”. Edhe mandej i kanë thonë, i kanë leju tash, se këta kanë bisedu qe t'mos bohet edhe ma e madhe. Janë ardhë, u konë ai... qysh u konë qì qe diç, *Holbrook*-u u konë këtu n'atë kohë, *Richard Holbrooke*. Mandej kanë bisedu. Mandej kjo... qysh u kanë ajo, për t'drejtat e njeriut, u konë ardhë... *Madeleine Albright*.

Nejtëm, qitu te këta kojshitë jemi dalë. Burri jem ka nejtë... ka u kthy kur e kanë vorrosë Bajram Kelmendin, o shku, ka punu, është angazhu rreth vorrimit. Mas nja dy dite i kishin pasë qitë n'periferi të Prishtinës, i kanë gjetë dy djemtë edhe këta. Mandej shkoi ky atje. U fshehke nëpër shpia. Ka qellu prej vorrimit t'Bajramit, ka hi me ni shpi qaty te Bahollët. Aty ka nejtë tri-katër netë. Pi atyne ka ardhë te knena apet, o hi me naj shpi. Masnej o hi qe qyky Havolli.

Une kur po dalë, dilshim me ble bukë, veç shkinat dilshin, këto tonat kërkun hiç. Edhe une me trenerka, me ni duks, e ka pasë djali jem t'kuq, me qato dilshim. Nisi me u nxehë moti, pranvera nisi me dalë. Ngajshin nëpër shitore me ble cigare, qitshin qaty tu ngajtë, tu ikë. Gjithqyshjeta, gjithqysh koka. E mandej erdhi te qita Havollët, ka nejtë një tri javë ditë te ta.

Erëmirë Krasniqi: A e dishe ti ku është ai?

Resmije Cana: Jo, nuk e dita. Po mandej ni masdite kur p'e shoh o ardhë n'shpi. Edhe shpiunat pa pare, kanë kallxu qe o ardhë. Po nuk hini n'shpi ai, o dalë ka qyky muri anej {tregon me dorë kah ana e majt e shpisë}. Natën, dilke rrrike qaty n'kolltuk, kerre t'prishta këta i kanë gjuitë, qaty u kanë hija, dy netë qaty ka flejë. Masanene çunë fjalë këta Havollët, qe, “Te na ka qenë promë,” e djali murrë vesh, “Mamë aty ish baba”. Mandej erdhi këtu, “Po iu bajë telash”. 50 vetë ishin konë mbledhë aty. Tash, edhe u tutshin njerëzit. E kemi pasë ni kushëri t'tonin, pi Bajram Kelmendit kur o dalë, i ka thanë, “A muj me ardhë, bile sonte?” “Jo, valla,” i ka thanë, “m'fal”. U tutë për veti, s'e ka pranu. Atëhere erdhi këtu, tha, “Sa shkojë i bajë telashe gjintë, e m'kqyrin me sy t'gazepit, une po vij këtu”.

Kur erdhi murren vesh, dulën masanej policia hallakatshin. I qitshin, i qitshin me shku, me dalë. Pra i merrshin t'ritë. Këtu i patën marrë një tre djemë. Me kombi dilshin i mbledhshin t'ritë. I kanë majtë kah dy-tri javë n'burg, masnej i lëshojshin. E djalin une e kisha, i vogli ish n'Austri. Ky i madhi shkoi te miqtë e vetë. Ky i dytë metë këtu. Te qita kojshitë patëm nejtë, masnej dulëm karshi këtu. Dilshin nëpër shpia, ku ka cigare, ku ka millë. Merrshin qitu te Lumi, patën pru millë për m'u shërbypatëm ble sheqer e, millë e. Masanej benzinë, u konë qetu, është barëm ajo e kësaj, familja e Myrvete Paqarada. Është prodekane n'Fakultet t'Mjekësisë. Ajo ka qenë me burrin e vet këtu, e nana e vet, e vëllazënët. E dilke i vëllai, kur shkojke nëpër shpia, iu merrke benzinë, e iu jepke masanena policisë. Nuk vishin knena kah na. Qesi farë *shalltitromesh*.

Mandej e patën thy ni depo, qysh e majshin këta si garazhë e kanë pasë. E kanë pasë lëshu me qira, qita përmi ne. E te thynë atë garazhë. Na n'titërr t'luftës pi *ice tea*, pi koka-kola (qeshet). Prunë detergjenta, qysh i ka pru ai, i ka lonë me qira me pagu, ia thynë. Dulën këta djemtë, e ia murrën atyne, e prunë tanave ka pak, thojke, “Për ty qito, për djalin tanë qito, për...” (qeshet). O Zot, o Zot! 5 qind vjet.

Edhe dulën me kqyrë kush është nëpër shpija. I morën qe thashë këta nëpër oborr, “Çka bojë unë? Kuku!” Kur erdhën, hinë këtu, ky djali jem i dyti, isha shku n’Gjakovë me bo kishe u kanë ushtar, a me ia shty ushtrinë a, se çojshin ftesa për ushtar, e ky s’e ka pasë kry, a ai i madhi e ka pasë kry ushtrinë. Kur erdhën, hinë këtu, policia, hishin shpi për shpi. “I kujna është ky kerr?” Ky kombi i këtyne, “Merrel! A keni kahin këtu?” “Jo.” Burri i jem ish qatje, te qato kerre ku po thomë. Djali ish’ mrena. Edhe hinë edhe thojshin, “Tonë me shku nëpër shpia t’vetat”. Hec e mos shko! Erdh’ ky n’shpi, djali. Pi atyne, se aty rrishin, erdh’ këtu n’shpi.

Kur erdh’ policia, “Šta ćeš ti ovde?” [“Çka je ka donë ktu?”] Thotë, “Ništa.” [“Kurgjo.”] “A je kanë... ku e ki shpinë?” Thotë, “Qitu e kom shpinë.” A e kisha bo une [djalin] banor t’Gjakovës. Jam shku qato netë kur ngajshin policia e i zishin. Une hypa n’autobus e shkova n’Gjakovë, e gjeta ni lidhje, ma dha ni vërtetim qe kishe, ma boni qe është banor i Gjakovës. Atje zjerimi, “Šta ćeš ti ovde? Šta si tamo hteo, da prevrneš kalašnikove? [“Çka je ka donë ktu? Çka ke kérku, me i kërsitë kallahnikovat?”] “Jo bre, ja sam sa babom ostao tamo.” [“Unë kam qëndru aty me gjyshën.”] Hinë ata e t’murrën, qatë natë qe po thamë, ni natë, për natë pritshe ti befasi pi tyne. E murren qatje te Novi Domi. Kur po vinë me policë, tri netë e majtën. Iu kishë bo qikaq leshi. Iu kishin çu sytë nuri, sytë kështu t’kuqe, me ato vijat pa gjumë. Tha, “Si isha tu nejtë ‘Reci!’ [‘Trego!'] veç kur i mshojshin tavolinës ‘bam’. Dojke me m’kotë gjumi, ata tavolinës”. Hajde kur u bo tetë sahati, na po çohëm, kur po vinë ata me shtatë policë. Këta e kishin qitë përpara. Ish’ bo...

Erëmirë Krasniqi: Djalin, a burrin?

Resmije Cana: Burrin. Këta ishin, ngajshin anej-teknej, te këta kojshitë, djali, njoni metë, edhe une. Ish’ bo ky sarih, pa gjumë gjithë natën. “Hajde, reci, reci” tha, “veç ma bojshin.” Kur t’hi këtu, “Jao, pa vi imate više teknike nego mi ovde dole sho imamo.” [“Uou, po ju paskët më shumë teknologji, se sa ne këtu poshtë.”] Sa aparatin, sa kasetofoni, pesë valixhe i murrën. Çka i thojshin, “Iredentističko”. Materiale merrshin, i mushën ato valixhe. Qysh janë konë këtu, hup se t’pashë. Edhe une e kom pasë edhe vulën e fakultetit, edhe ata e murrën atje. Shpesh thojsha, “Po shkoj Zeqë, po kqyri”. E lëshunë këta, e lanë këtu. Çantat i murrën, ku i kanë pasë këta kojshitë. Kuku, nonë! Jemi tutë qe çka po i bojnë tash. Ata tu kqyrë nëpër flamqirita [dylbi] çka po bohet me këta. Me këpuca hinë. Unë edhe pa nja pa dy pi thomë, “Izvinite, morate da se izujete.” [“Më falni, por duhet t’i zbathni këpucat”] Tha, “Bog zna šta imate vi unutra.” [“Zoti e din çka keni ju brenda.”] najani me na vra, e asi, e [thotë], “Imamo naredjenje, ne može da se izlazi... ulazi, da se izuje kad se ulazi.” [“Kemi urdhër, nuk bënë t’dalim... hyjmë, të zbathemi kur të hyjmë.”] Mos, nuk i deshën. Hinën i marrë qato, qanë. Shtatë vetë. Qatëhere e ka pasë ble djali kompjuterin. Shkojke qyky Liraku me marrë benzinë Tetovë, e shkojshin e shitshin n’Gjakovë. Filma t’vizatumë.

Erëmirë Krasniqi: Kur u kthytë n’punë ju mandej kur u kry lufta? A u kthytë menihere n’punë, a qysh?

Resmije Cana: Po, po meniherë. Na këtu ishim, nisëm me na thirrë. U kthymë.

Erëmirë Krasniqi: Kush iu thirri?

Resmije Cana: Na thirri qaj sekretari qe u konë. Mandej ke bo dekani shqiptar, ma herët po menoj. Pi atjehit e prumë na, pi shpie veprumë këtu. Nisëm niherë me shku atje, mandej n’mënyrë solemne u bajshin nëpër tonë fakultetet, shkojshin.

Erëmirë Krasniqi: N'ndërtesa, apo?

Resmije Cana: N'ndërtesa, po. Ashtu pak ma solemnisht. Po o konë çu krejt Prishtina n'kamë tu ngajtë me shku nëpër fakulte, nëpër vende t'punës, t'vetat. A me datë, nuk di.

Erëmirë Krasniqi: Deri kur keni punu n'Fakultet Ekonomik, Ekonomiko-Juridik?

Resmije Cana: Ja, Ekonomik. Me t'70-tën u kanë Ekonomiko-Juridik, mandej u nda Ekonomik. Une n'Ekonomik, ata tjertë Juridik. Po na me ni ndërtesë jena kanë.

Erëmirë Krasniqi: Deri kur keni qenë aty?

Resmije Cana: N'Fakultet? Deri kur jam dalë n'pension.

Erëmirë Krasniqi: 2009?

Resmije Cana: Po. 2009-ën, po. Qeshtu qe.

Erëmirë Krasniqi: A keni naisen me shtu?

Resmije Cana: Me shtu kom boll, po nuk iu kallxova kurgjo (qeshet). Me shtu kom boll, po pa data, pa asi, pa busullë, pa kompas. Lu kérkoj falje, kom qenë e shkapérderdhne, po qekaq është niveli i jem. Edhe mosha, edhe harresa, edhe kanë ardhë gjana t'tjera, t'rejat.